



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 32 regjistri (JR)
Datë 12.11.2018

Nr. 28 i vendimit
Datë 30.10.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga:

Albana Shtylla	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Ardian Hajdari	Anëtar
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare

– mori në mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 30.10.2019, ditën e mërkurë, ora 9:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia Roessingh-Bakels, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 32, datë 12.11.2018, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ervin N. Metalla, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 45, datë 23.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59, 63 dhe 66 pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, i cili bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 kërkoi përfundimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit – të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale – dhe ndryshimin e vendimit nr. 45, datë 23.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Ervin Metalla, në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ka ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) duke u shortuar më datë 30.11.2017, pasi u përzgjedh me short për të qenë anëtar në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, në bazë të nenit 284, pika 9 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.
2. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) i ka dërguar Komisionit raportin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016¹, duke konstatuar se:
 - i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
 - ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
 - iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
 - iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
 - v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
3. Me vendimin nr. 1, datë 12.12.2017, trupi gjykues i Komisionit vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016.
4. Më datë 25.06.2018, trupi gjykues vendosi të përfundojë hetimin për subjektin e rivlerësimit vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke arritur në përfundimin se provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë vetëm për këtë kriter dhe të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit.
5. Më datë 09.07.2018, subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e tij së bashku me provat me anë të postës elektronike, duke kërkuar: i) revokimin e vendimit të ndërmjetëm për përfundimin e hetimit administrativ kryesisht vetëm për kriterin e pasurisë dhe vazhdimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, atë të figurës dhe të aftësive profesionale; ii) revokimin e vendimit të ndërmjetëm për të konsideruar vëllain E. M. si “person tjetër të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, si dhe çlirimin e tij nga barra për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tij; iii) marrjen si provë, në mbështetje të vërtetësisë së shpjegimeve dhe deklarimeve të tij, të dokumenteve bashkëlidhur materialit shpjegues. Këto kërkesa subjekti i rivlerësimit i parashtroi edhe gjatë shpjegimeve të tij në seancën dëgjimore të zhvilluar në Komision, më datë 18.07.2018.
6. Trupi gjykues i Komisionit vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e hetimit edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale, bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni arsyetoi se për kriterin e kontrollit të pasurisë provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë për këtë kriter sipas ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe provat e paraqitura nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës². Po ashtu, Komisioni e vlerësoi të pabazuar në prova dhe në ligj³ kërkesën e subjektit të rivlerësimit për revokimin e vendimit që cilësoi vëllanë e tij E. M. person tjetër të lidhur. Në lidhje me provat dhe kërkesat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit konsideroi marrjen e dëshmimeve nga z. N. D. dhe znj.

¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 13.11.2017.

² Shih faqen 3 të vendimit të Komisionit.

³ Shih faqen 21 të vendimit të Komisionit.

B. D., si dhe këqyrjen e objektit/pallatit nr. {***}, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, të panevojshme. Komisioni arsyetoi se fakti që kërkohej të provohej nga subjekti i rivlerësimit, konsiderohet nga trupi gjykues i provuar gjatë gjykimit të çështjes administrative.⁴

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me vendimin nr. 45, datë 23.07.2018, ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.
8. Vendimi i mësipërm është marrë bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë pasi Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm për këtë kriter. Sipas Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë e rezultateve të hetimit. Sipas Komisionit, në vlerësim tërësor të procedurave për kriterin e kontrollit të pasurisë, për qëllim përfitimi financiar, subjekti i rivlerësimit ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive të simuluara, të cilat nuk përputhen me sjelljet etike që një gjyqtar pritet të ketë. Konkretisht:
 - i) kontrata paraprake nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2007, është lidhur duke mos pasur qëllim të sillte pasoja juridike në lidhje me elementin kryesor të një kontrate shitjeje, çmimin, por për të përfituar një kredi nga Banka Alpha që do të mbulonte të gjithë çmimin e apartamentit që synohej të blihej, dhe jo thjesht 70% të vlerës së tij, siç parashikonin kushtet e kontratës së kredisë;
 - ii) kontrata midis subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur me të [vëllait E. M.], sipas së cilës ky i fundit zëvendëson subjektin e rivlerësimit në blerjen e apartamentit në rrugën “{***}” dhe në kredinë nga Banka Alpha, është lidhur pa qëllimin real për t’u përmbushur, por për të plotësuar kushtet formale që nevojiteshin që subjekti i rivlerësimit të dukej se përmbushte kriteret për të përftuar një kredi të butë;
 - iii) kontrata fiktive me shoqërinë “{***}”ShPK, për blerjen e një apartamenti në Durrës, është lidhur për të përftuar shumën 4.900.000 lekë nga kredia e butë e Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”), pa qëllimin për ta përmbushur atë. Në fakt, siç dëshmojnë veprimet e mëpasshme të tërheqjes nga kontrata dhe fillimi i një marrëdhënieje me shoqërinë “{***}”ShPK për një apartament në Tiranë, subjekti i rivlerësimit synonte që, me shumën e përftuar nga kredia e butë, të blinte një apartament në Tiranë. Kredia e butë e marrë nga subjekti i rivlerësimit në BKT, nuk është përdorur për qëllimin për të cilin është marrë dhe nga dosja nuk rezulton që banka të ketë qenë e informuar për këtë përdorim të huas, përtej projektit thelb të kontratës;
 - iv) jeta personale e gjyqtarëve, sjellja e tyre jashtëgjyqësore, është po aq e rëndësishme sa ajo në kontekstin profesional. Standarde të sjelljes etike të gjyqtarëve janë shtjelluar shterueshëm dhe vazhdojnë të shtjellohen nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”), lidhur me paanësinë, në “Teorinë e dukjes”, standardet e etikës zbatohen edhe jashtë gjykatës dhe përfshijnë jetën private, duke kërkuar që gjyqtarët të sillen me integritet dhe në një mënyrë të denjë për detyrën.
9. Në konkluzionet përfundimtare, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit:
 - a) nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës;
 - b) ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës;

⁴ Shih faqet 5 dhe 6 të vendimit të Komisionit.

- c) ka bërë deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, bazuar në paragrafin 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

10. Subjekti i rivlerësimit Ervin Metalla, më datë 25.10.2018, ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 45/2018, të Komisionit. Ky ankim është pranuar nga trupi gjykues me vendimin nr. 4, datë 26.10.2018.
11. Ankimi bazohet në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenet 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit i mbështet kërkesat e tij në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar përfundimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit – kontrollin e figurës dhe të aftësive profesionale – dhe ndryshimin e vendimit nr. 45, datë 23.07.2018, të Komisionit, duke vendosur konfirmimin e tij në detyrë.
12. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit kundër vendimit nr. 45/2018 të Komisionit, në mënyrë të përmbledhur janë si në vijim.
- i) Lidhur me zgjidhjen e çështjes në themel ose meritat e zgjidhjes së rastit, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Sipas tij, asnjë nga kontratat e cituara nga Komisioni nuk është fiktive apo e simuluar. Përfitimi i kredisë së butë është i rregullt, pasi përmbushen kushtet ligjore për ta përfitur atë; shlyerja e kredisë së butë vazhdon; destinacioni i kredisë nuk është ndryshuar asnjëherë dhe ka qenë përmbushja e nevojave të subjektit si gjyqtar për strehim. Po kështu, subjekti i rivlerësimit pretendon se:
1. nuk ka kryer asnjë veprim që të përbëjë sjellje joetike për një gjyqtar. Përkundrazi, nëse do të kishte përfunduar hetimi për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, do të rezultonte që sjellja e tij jashtëgjyqësore, ndryshe nga sa ka arsytuar Komisioni, konsiston në një kontribut të shtuar për sistemin e drejtësisë;
 2. ka shpjeguar bindshëm në mënyrë të plotë dhe të saktë, pa ndërmarrë asnjë hap për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë, burimin e ligjshëm të “së vetmes pasuri të paluajtshme në pronësi, posedim dhe gëzim: apartament banimi dhe garazh, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë”⁵ dhe nuk ka kryer deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë;
 3. përfundimi i Komisionit lidhur me cilësimin e vëllait [E. M.] si “person tjetër i lidhur” me subjektin e rivlerësimit, nuk është i bazuar në fakte dhe në ligj.
- ii) Lidhur me procesin dhe zhvillimin e procedurës, subjekti i rivlerësimit pretendon se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt, parashikuar nga neni 6 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNJ”), nga Komisioni, pasi:
1. përfundimi i procesit të rivlerësimit bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, përbën cenim të parimit të sigurisë juridike;
 2. vendimi i Komisionit është pjesërisht i paarsytuar, kontradiktor, si dhe në kundërshtim me qëndrimet e vetë Komisionit në çështje të ngjashme;
 3. Komisioni ka kërkuar në kundërshtim me ligjin që subjekti të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të të gjitha pasurive në pronësi të vëllait [E. M.], përgjatë tërë jetës, pa pasur vetë subjekti asnjë lidhje me to dhe duke e ngarkuar këtë të fundit me një barrë të shpërpjesëtuar prove;
 4. Komisioni ka vendosur shkarkimin duke u bazuar në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që kërkon njëkohësisht veç deklarin të pamjaftueshëm për kriterin e

⁵ Shih paragrafin 4.2. në faqen 41 të ankimit.

kontrollit të pasurisë, edhe deklarim të pamjaftueshëm sa i takon kriterit të kontrollit të figurës, hetimi administrativ për të cilin nuk ka përfunduar prej Komisionit.

13. Subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur ankimit tri dokumente⁶:
- i) informacion/vërtetim nga studio ligjore “{***}”, datë 19.10.2018, drejtuar z. E. M., sipas të cilit marrja e informacioneve dhe/ose dokumenteve të tjera shtesë për të ardhurat nga dëmshpërblimet e përfituara nga shoqëria e sigurimit “{***}”{***}, si pasojë e përfshirjes në aksidentin rrugor të ndodhur në vitin 1999, nuk është e mundur;
 - ii) praktikën spitalore lidhur me aksidentin në trafik të z. E. M., datë 25.04.1999, reparti i ortopedisë, për frakturë në këmbë, periudha 27.04.1999 – 04.05.1999;
 - iii) certifikatën e të ardhurave për z. E. M., lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave/Drejtoria e Provincës {***} /Zyra Territoriale {***} Itali, më datë 18.07.2018, sipas së cilës në bazë të të dhënave të sistemit informativ të Zyrës së Taksave vërtetohet se E. M., Kodi Fiskal {***}, rezulton të ketë përfiturar të ardhurat si vijojnë për vitet fiskale 2001, 2003, 2005 dhe 2006 respektivisht: viti i taksave 2001 – 5478 euro; viti i taksave 2002 – 5348 euro; viti i taksave 2003 – 1781 euro; viti i taksave 2005 – 2690 euro; viti i taksave 2006 – 2433 euro.
14. Në datën 10.10.2019, në përputhje me afatin 5-ditor para zhvillimit të seancës gjyqësore në dhomë këshillimi në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur parashtrime në formën e shtesës së ankimit, mbështetur në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”). Në mënyrë të përmbledhur, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar si në vijim.
- i) Nuk qëndron përfundimi i Komisionit se kontrata paraprake e blerjes së apartamentit në vitin 2007 nuk ka pasur për qëllim të prodhojë pasoja ligjore për sa i përket çmimit dhe që e vetmja pasojë e synuar ka qenë përfitimi i kredisë që të mbulonte të gjithë vlerën. Për të mbështetur këtë pretendim, subjekti paraqiti pjesë nga arsyetimi i Komisionit në vendimin nr. 57, datë 01.08.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. B. K..
 - ii) Deklarimet e tij lidhur me kërkesën për kredi të butë në vitin 2006 janë të vërteta, duke sjellë për kundërgargument mosadministrimin nga Komisioni të një kërkesë të ngjashme të tij në vitin 2010 apo 2011.
 - iii) Interpretime të ndryshme që ka bërë Komisioni në raste të tjera të ngjashme. Subjekti solli në vëmendje rastin e subjekteve të rivlerësimit A. Xh. dhe E. H., lidhur me veprimet e ndërmarra prej tyre për zëvendësimin e kredisë tregtare me kredinë në kushte lehtësuese.
 - iv) Statusi “i pezulluar” i shoqërisë “{***}”ShPK nuk ka efekt mbi të drejtat e subjektit apo detyrimin që kishte marrë përsipër shoqëria e pezulluar, për sa kohë ajo vazhdonte të kishte personalitet juridik. Në mbështetje të këtij argumenti, subjekti sjell në vëmendje arsyetimin e Komisionit në rastin e subjektit të rivlerësimit E. Dh..
 - v) Vendimi i Komisionit për të konsideruar “person tjetër të lidhur” vëllanë [E. M.] është haptazi i pabazuar në fakte dhe në ligj. Komisioni nuk ka zbuluar asnjë dhurim, hua apo marrëdhënie biznesi ndërmjet subjektit dhe vëllait, dhe nuk ka asnjë gjurmë, indicie apo provë ku të bazohet dyshimi për fshehje pasurie. Në këtë aspekt, subjekti parashtron, ndër të tjera, se:
 - ° është vënë në dijeni për herë të parë nëpërmjet vendimit të Komisionit për cilësimin e vëllait E. M. *person tjetër i lidhur* për shkak të vendosjes si kolateral të shtëpisë së tij për të garantuar kredinë me kushte lehtësuese të marrë nga subjekti pranë BKT-së. Relacioni para seancës dëgjimore nuk e përmend cilësimin e E. M. *person tjetër i lidhur* për këtë shkak. Mbi konceptin e personit tjetër të lidhur, subjekti ka sjellë në vëmendje

⁶ Dy dokumente janë paraqitur si fotokopje, ndërsa vërtetimi nga institucionet italiane është paraqitur i përkthyer dhe i noterizuar, por pa vulë apostile.

arsyetimin e Komisionit në rastin e subjekteve të rivlerësimit S. S., K. B. dhe A. D., ku garantuesit apo dorëzanësit e kredive respektive, në asnjë rast, nuk janë konsideruar *person tjetër i lidhur* me subjektin e rivlerësimit;

- vendimi i Komisionit për cilësimin e vëllait E. M. si person tjetër i lidhur, shoqëruar me barrën për të provuar ligjshmërinë e burimit të pasurive të tij, pa pasur subjekti asnjë lidhje me to, përfaqëson një vendim arbitrar, të pabazuar në fakte dhe ligj. Në mbështetje të vlerësimit të tij, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje arsyetimin e Komisionit në rastin e subjektit të rivlerësimit O. Ç. dhe arsyetimin e Kolegjit në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. A. B., lidhur me kuptimin e përfitimit të njëanshëm, si premisë faktike që shërben ligjërisht për ta cilësuar të tretin, ofruar të këtij përfitimi, si *person tjetër i lidhur* me subjektin e rivlerësimit;
- tejkalimin e ligjit nga Komisioni, duke i ngarkuar subjektit një barrë të pakufizuar prove për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të të gjitha pasurive në pronësi të vëllait, me të cilat subjekti nuk ka asnjë lidhje;
- meqenëse cilësimi i E. M. si person tjetër i lidhur ishte i pabazuar në ligj, Komisioni nuk ka qenë i autorizuar të kërkonte informacion për persona të tretë siç e kërkon ligji, në mënyrë të tillë që të kishte edhe një qëndrim, pasi të kishte konfirmuar ekzistencën e kësaj marrëdhënieje nga personi i tretë në fjalë, e më pas ta kishte pasqyruar në një vendim të ndërmjetëm të argumentuar. Konsiderimi i vëllait si person tjetër i lidhur me subjektin është bërë në mënyrë mekanike, artificiale dhe të sforcuar, duke cituar si shkaqe: cedimin e kredisë tregtare me qëllim përfitimin e një kredie të butë dhe garantimin e kësaj të fundit me hipotekë;
- nuk mund të ketë rrethana të tjera përtej dhurimit, huas apo marrëdhënieve të biznesit, dhe të fshehjes së pasurisë në pronësi faktike të subjektit në emër të një personi të tretë, që të kualifikojë këtë të fundit “person tjetër të lidhur” me subjektin e rivlerësimit, në kuptim të ligjit;
- në kushtet kur vendimi i Komisioni nuk është i arsyetuar lidhur me ndonjë marrëdhënie ndërmjet subjektit dhe vëllait, duket sikur aludohet për një fshehje të mundshme, të paspecifikuar pasurie, dyshim i krijuar në mënyrë “kryekëput spekulative” pasi nuk bazohet në asnjë gjurmë, indicie apo provë;
- lidhur me interpretimin e pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe të efektit të nenit D, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje të Kolegjit qëndrimin e mbajtur në “Komentarin mbi reformën kushtetuese në sistemin e drejtësisë”;
- lidhur me kalimin e barrës së provës, subjekti sjell në vëmendje qëndrimin e GjEDNj-së, sipas të cilit kalimi i barrës së provës nuk duhet të jetë i bazuar thjesht në dyshime dhe automatik⁷.

15. Për të vërtetuar faktin që nuk ka pasuri të fshehur në emër të vëllait, subjekti i rivlerësimit i ka bashkëlidhur shtesës së ankimit kopjen e njësuar të raportit të DSIK-së. Në këtë dokument, DSIK-ja e konstaton subjektin të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës⁸ dhe, për rrjedhojë, nuk ka referencë në pasuri të fshehur.

⁷ Shih paragrafin VIII.ix - faqet 7 dhe 8 të shtesës së ankimit.

⁸ DSIK-ja i ka kthyer përgjigje subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 06.12.2018, bashkëlidhur së cilës gjendet raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, i deklasifikuar plotësisht nga KDZh-ja.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

I) Juridiksioni i Kolegjit

16. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) të shqyrtojë ankimet e subjekteve të rivlerësimit kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e tyre. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Ankimet ndaj vendimeve të Komisionit në Kolegji shqyrtohen sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016⁹.

II) Legjitimimi i ankuesit

17. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës që parashikon mundësinë e ankimit nga subjektet e rivlerësimit në Kolegji të vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Ankuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016¹⁰.

III) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

18. Në zbatim të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit ndaj vendimit nr. 45/2018 të Komisionit u bë në bazë dokumentesh në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi. Pasi shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me ankimin dhe shtesën e ankimit, trupi gjykues vlerësoi se nuk gjente zbatim asnjë nga rrethanat e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, që do të krijonte nevojën e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve apo të krijonte nevojën e debatit gjyqësor. Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 parashikon:

[...] 1. Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se:

⁹ Neni 65 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: “1. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. 2. Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. 3. Në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Apelimit e gjykon çështjen në seancë publike.”

¹⁰ Vendimi nr. 45/2018 i Komisionit është marrë nga subjekti më datë 12.10.2018, pasi i është njoftuar me shkresën nr. {***} prot., datë 11.10.2018, nëpërmjet shërbimit postar. Më datë 25.10.2018, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankimin pranë Komisionit, të pranuar nga Komisioni me vendimin nr. 4, datë 26.10.2018 (protokolluar në Komision me nr. {***} prot., datë 25.10.2018). Ky vendim i është komunikuar subjektit të rivlerësimit me shkresën nr. {***} prot., datë 29.10.2018, nëpërmjet shërbimit postar.

- a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji;
- b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë;
- c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë [...].

18.1. Pavarësisht se mungonte një kërkesë e shprehur nga subjekti i rivlerësimit për marrjen e akteve të sjella prej tij në cilësinë e provës¹¹, duke qenë se subjekti referon përpjekjet e bëra për të siguruar dokumentacionin provues për të ardhurat e vëllait nga emigracioni në Itali, trupi gjykues ia nënshtroi ato analizës ligjore me qëllim garantimin e një vlerësimi tërësor të çështjes, duke pasur parasysh edhe përcaktimet e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 që parashikon rastet e sjelljes së provave të reja në ankim për arsye pamundësie të ankuesit për t'i sjellë ato në shkallë të parë¹² për shkak se shkresat e sjella me ankimin (shih poshtëshënimin 12) u kërkuar jashtë kufijve të Shqipërisë dhe i përkasin një periudhe kohore të gjatë që nga kthimi i të vëllait nga Italia (2008 – 2018)¹³. Në analizë të këtyre akteve, trupi gjykues konstaton mungesë vlere provuese për shkaqe forme, por edhe përmbajtësore.

18.2. Më konkretisht, dy dokumente janë fotokopje të thjeshta, ndërsa shkresa zyrtare nga autoritetet fiskale italiane është e përkthyer dhe e noterizuar, por i mungon vula apostile. Për të qenë tejet garantist, edhe duke marrë në shqyrtim përmbajtjen duke abstraguuar nga forma, trupi gjykues gjithsesi refuzoi marrjen e tyre si provë në dritën e nenit 49, pika 6, germat “a”, “b”, “c” dhe “d” të ligjit nr. 84/2016, pasi janë të panevojshme, të parëndësishme për vendimmarrjen, të papërshtatshme dhe në pamundësi për të ndryshuar gjendjen faktike të konstatuar nga Komisioni.¹⁴

18.3. Germet “a”, “b” dhe “d” gjejnë zbatim pasi edhe sikur të merren të vërteta, të dhënat për të ardhurat dhe shpërblimi për aksidentin janë të panevojshme, nuk ndikojnë në vendimmarrje dhe janë të parëndësishme në analizën në tërësi, pasi dëshmojnë për një sasi modeste të ardhurash, në total prej 17.730 eurosh, gjatë periudhës 2001 – 2006, në Itali të E. M.. Sipas analizës financiare të kryer në Kolegj, bazuar në të dhënat zyrtare nga Istat Itali, E. M. është në pamundësi financiare për të përballuar edhe shpenzimet e jetesës sipas nivelit të varfërisë¹⁵ dhe, si pasojë, përjashtohet mundësia për të pasur mjete financiare të tjera që mund të shërbenin për hua apo dhurata e investime.

¹¹ Aktet e listuara në paragrafët 13 dhe 15 më sipër, respektivisht.

¹² Neni 47 i ligjit nr. 49/2012 parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.”

¹³ Neni 32, pika 2 parashikon: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...]”.

¹⁴ Neni 49, pika 6, germet “a”, “b”, “c” dhe “d” parashikojnë: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjyqimit; c) mjeti i provës është tërësisht i papërshtatshëm ose i paarritshëm; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit [...]”.

¹⁵ Të dhënat statistikore të Eurostat mbi shpenzimet e një personi të vetëm në nivelin e varfërisë, nxjerrë nga linku: https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/shot.do?dataset=ilc_li01&lang=en; Të dhënat statistikore të

18.4. Shkresa tjetër e sjellë nga subjekti (shih paragrafin 13.i) i referohet pamundësisë së gjetjes së dokumentacionit nga shoqëria e sigurimit lidhur me një dëmshpërblim të pretenduar të përfituar nga E. M. pas një aksidenti rrugor në Itali në vitin 1999. Sipas subjektit, dëmshpërblimi u vlerësua dhe përfitua në vlerën 30 milionë lireta (rreth 2 milionë lekë). Përpos sa më sipër, në fashikull nuk rezulton asnjë dokumentacion provues lidhur me këtë dëmshpërblim që, si pasojë, mbetet në nivel deklarativ. Siç është shtjelluar më sipër në paragrafin 18.1, në funksion të një qëndrimi tejet garantist, trupi gjykues kreu një analizë financiare në të cilën vlerësoi situatën financiare të E. M. në periudhën kohore në fjalë, në alternativën që dëmshpërblimi merrej i mirëqenë. Në përfundim të kësaj analize teorike, trupi gjykues konkludoi se edhe duke e përlllogaritur të përfituar dëmshpërblimin e pretenduar, ky i fundit provon të ardhura në nivelin e varfërisë deri në vitin 2002¹⁶ dhe përjashton mundësi reale për kursim.

18.5. Këto të ardhura, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, kanë shërbyer për krijimin e pasurive të paluajtshme (dy apartamente të blera në vitin 2008) dhe të luajtshme (likuiditete në formën e bonove të thesarit) nga ana e E. M.. Subjekti i rivlerësimit parashton se ka njoftuar Komisionin se vëllai i tij nuk ka pasur mundësi objektive dhe as kohë të mjaftueshme që të sigurojë dokumentacionin justifikues nga periudha e emigracionit dhe as nga dëmshpërblimi, duke paraqitur shkresën e studios ligjore “{***}”, datë 02.07.2018¹⁷. Nga shkresa në fjalë, rezulton se informacioni dhe dokumentacioni i kërkuar nuk mund të merret në rrugë elektronike apo aplikim *on line* dhe se ka filluar procedurat për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit për të ardhurat e realizuara në Itali gjatë periudhës 1997 – 2007 (si punëmarrës dhe nga dëmshpërblimi i aksidentit), pranë Zyrës Rajonale të Tatimeve-Taksave dhe INPS (Instituti Kombëtar për Sigurimet Shoqërore) në Itali. Kjo procedurë, sipas së njëjtës shkresë, nuk mund të përfundonte brenda datës 10.07.2018. Në shkresën e datës 19.10.2018 (bashkëlidhur ankimit), kjo studio ligjore informon se ka qenë e pamundur marrja e informacionit shtesë apo detajeve në lidhje me dëmshpërblimin për E. M., për shkak të riorganizimit të shoqërisë së sigurimit dhe kohës së gjatë që ka kaluar.

18.6. Trupi gjykues vëren se për shkak të mungesës së formës së kërkuar nga ligji për këto akte, gjen zbatim germa “c” e nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016. Ndër to, vetëm certifikata e të ardhurave për z. E. M., lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave/Drejtoria e Provincës {***/Zyra Territoriale {***}, Itali, më datë 18.07.2018, është e përkthyer nga përkthyes e autorizuar dhe e noterizuar kopja me origjinalin. Kjo shkresë nuk shoqërohet me vulë apostile. Dokumentacioni i marrë nga spitali lidhur me aksidentin e z. E. M. në prill të vitit 1999 është fotokopje, e panoterizuar, e papërkthyer dhe e pashoqëruar me vulë apostile. Forma e këtij

*Istat Italia mbi shpenzimet e një familjeje mesatare në nivelin e varfërisë, nxjerrë nga linku: http://dati.istat.it/#/totali_i_shpenzimeve_në_nivelin_e_varfërisë_për_një_familje_mesatare_sipas_Istat_Italia_për_periudhën_1999-2006 është 90.342 euro; totali i shpenzimeve në nivelin e varfërisë për një person në Itali, sipas Eurostat për periudhën 1999-2006 është 43.324 euro (pa përfshirë vlerat për vitet 2002 dhe 2003, për të cilat nuk ka të dhëna të publikuara nga Eurostat). Të ardhurat totale të dokumentuara nga certifikata e të ardhurave për E. M., lëshuar nga Agjencia e të Ardhurave {***} më datë 18.07.2018, për periudhën 1999-2006, janë 17.730 euro, dukshëm më të ulëta se shpenzimet në nivelin e varfërisë sipas të dy burimeve zyrtare të statistikave për periudhën në fjalë.*

¹⁶ Sipas kursit historik të këmbimit, nxjerrë nga linku:

https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/, 30 mln lireta janë ekuivalenti i rreth 2.000.000 lekëve ose 15.500 eurove. Hipotetikiisht, këto të ardhura mund të shërbenin për të mbuluar shpenzimet e jetesës deri në vitin 2002, duke përlllogaritur shpenzimet në nivelin e 24.065 euro për periudhën 1999-2002 për nivelin e varfërisë sipas Eurostat. Ndërkohë, nëse do të përdorej Istat Italia si bazë statistikash, këto të ardhura mund të shërbenin për të mbuluar shpenzimet e jetesës deri në mesin e vitit 2000, duke përlllogaritur shpenzimet në nivelin e 15.411 eurove për periudhën janar 1999 - qershor 2000 për nivelin e varfërisë sipas Istat Italia.

¹⁷ Administruar në fashikullin {***}, faqe {***}.

dokumentacioni nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”).¹⁸

18.7. Në analizë të ligjit dhe rrethanave faktike, trupi gjykues vlerësoi se nuk gjejnë zbatim edhe kushtet e tjera të parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, pasi nuk nevojitet të merren prova apo vërtetohen fakte të reja¹⁹. Konkretisht, nuk gjen zbatim germa “b” e pikës 1 të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, pasi nga përmbajtja e ankimit dhe nga analiza e vendimit të Komisionit nuk rezulton të jenë parashtruar apo kryer shkelje procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike e konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni. Debati gjyqësor me praninë e subjektit është i panevojshëm, pasi nuk rezulton të jetë cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor (çështje e trajtuar më tej në këtë arsyetim, që lidhet me shkakun e ankimit për cenimin e procesit të rregullt ligjor). Së fundmi, nuk gjen zbatim as germa “c” e pikës 1 të nenit 51 pasi përsëritja e marrjes së provave, në vijim edhe të sa më sipër, nuk është e nevojshme.

18.8. Bazuar në këtë vlerësim dhe në shkaqet procedurale të trajtuara më sipër, nga materialet e administruara nga Komisioni, rezultuan të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar pretendimet e subjektit të rivlerësimit në seancë gjyqësore në dhomën e këshillimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

19. Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit lidhen me zgjidhjen e çështjes në themel nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe me zhvillimin e procesit që, sipas subjektit të rivlerësimit, ka cenuar të drejtat e tij për një proces të rregullt ligjor dhe parimin e sigurisë juridike, të parashikuara nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së.

I) Shkaqet e ankimit që lidhen me zgjidhjen e çështjes në themel për kriterin e vlerësimit të pasurisë

20. Subjekti pretendon se vendimi i Komisioni është i pabazuar në fakte dhe në ligje, pasi asnjë nga kontratat e cituara nga Komisioni nuk është fiktive apo e simuluar dhe përfitimi i kredisë së butë është i rregullt, duke qenë se përmbusheshin kushtet ligjore për përfitim dhe shlyerja e kredisë vazhdon duke mos e ndryshuar asnjëherë destinacionin e saj, si dhe ajo ka përmbushur nevojat e subjektit si gjyqtar për strehim. Në analizë të provave dhe shkaqeve të ankimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se:

21. Për kontratat që kanë lidhje me kreditë e përfituara nga Banka Alpha dhe BKT, Komisioni ka konkluduar se, bazuar në nenin D, paragrafët 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij, dhe shpjegimet e tij nuk kanë arritur të provojnë të kundërtën e barrës së provës.

22. Lidhur me rrethanat që paraprinë marrjen e kredisë nga Banka Alpha, subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e arritur nga Komisioni se kontrata paraprake e shitjes [me nr. {***} rep., nr. {***} kol.], e datës 18.07.2007, është lidhur duke mos pasur qëllim të sillte pasoja juridike në lidhje me çmimin, një element parësor i një kontrate shitjeje, por për të përfituar një kredi që do të mbulonte të gjithë çmimin e apartamentit që synohej të blihej, jo thjesht

¹⁸ Kodi i Procedurës Civile në nenin 266 përcakton: “[...] Kur shkresa është në gjuhë të huaj, ajo paraqitet bashkë me përkthimin e saj në gjuhën shqipe, të legalizuar nga ambasada apo konsullata përkatëse ose nga organi tjetër kompetent. Kur gjykata nuk mund ta kontrollojë vetë saktësinë e përkthimit, emëron përkthyes.”

¹⁹ Neni 51, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 49/2012.

70% të vlerës së tij. Sipas subjektit, ky përfundim i Komisionit është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Në mbështetje të këtij shkakut ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtron se:

i) mungon interesi publik, pasi bëhet fjalë për një marrëdhënie juridike private ndërmjet një qytetari (jo gjyqtarit) dhe bankës. Banka ishte në dijeni të plotë të faktit se në projektin (kontrata paraprake me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2007) që po financonte, çmimi ishte i përcaktuar në mënyrë jopërfundimtare, por ishte i përcaktueshëm nga 75.000 euro në maksimum deri në jo më pak se 70% të kësaj shume në minimum;

ii) nuk ka ndryshuar çmimi i kontratës paraprake të shitjes. Me deklaratën noteriale [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] të datës 17.12.2007 u përmbush detyrimi i parashikuar në nenin 2 të kontratës paraprake të shitjes [me nr. {***} rep., nr. {***} kol.] të datës 18.07.2007 dhe banka ishte në dijeni të këtij fakti. Kjo sjellje e palëve kontraktore parashikohet edhe nga neni 707 i Kodit Civil²⁰;

iii) palët kontraktore janë sjellë në mirëbesim dhe kanë përmbushur detyrimet e parashikuara në nenin 674 të Kodit Civil²¹ pasi banka ishte në dijeni të plotë që po financonte blerjen e një prone ende të paligjësuar në qarkullimin juridiko-civil, si dhe të faktit që po financonte një kredi për një çmim të blerjes së sendit që mund të ndryshonte;

iv) marrëdhëniet e mirëbesimit dhe korrektesës ndërmjet palëve kontraktore është dëshmuar edhe në vitin 2011, kur banka pranoi zëvendësimin e subjektit me një debitor tjetër dhe në vitin 2017 kur ka miratuar një kredi në vlerën 32.000 euro në favor të bashkëshortes së tij, ku subjekti rezultoi debitor solidar;

v) kontrata paraprake e shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2007, nuk është fiktive dhe e simuluar; ajo prodhoi pasojën kryesore juridike të synuar nga palët që lidhej me kalimin e të drejtës reale/të drejtës mbi pronësinë e apartamentit objekt material i saj.

23. Subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e Komisionit, sipas të cilit subjekti ka treguar sjellje joetike, si të pabazuar në fakt dhe në ligj, duke parashtruar se Komisioni nuk ka cituar shkeljen konkrete të Kodit të Etikës apo ndonjë vendim konkret të GjEDNj-së që trajton sjelljen e supozuar joetike të subjektit. Po aty, subjekti parashtron se shkeljet e etikës nuk parashikohen në ligjin nr. 84/2016 si shkaqe për dhënien e masës së shkarkimit nga detyra.
24. Në shtesën e ankimit, subjekti i rivlerësimit referon një sërë vendimesh të marra nga Komisioni në raste të tjera, për të argumentuar qëndrime të ndryshme në raste të ngjashme me të.
25. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar në prova dhe në ligj përfundimin e Komisionit se kontrata midis subjektit të rivlerësimit dhe personit tjetër të lidhur me të – vëllait E. M.– për zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit në blerjen e apartamentit në rrugën “{***}” dhe në kredinë me Bankën Alpha – është lidhur pa qëllim real për t’u përmbushur. Komisioni ka konkluduar se qëllimi i kësaj kontrate ishte që subjekti i rivlerësimit të dukej se

²⁰ Neni 707 i Kodit Civil parashikon: “Në qoftë se palët nuk e kanë caktuar çmimin, as nuk janë marrë vesh për mënyrën e caktimit të tij, në mungesë të ndonjë akti të organeve kompetente publike, prezumohet se palët kanë dashur t’i referohen çmimit të zbatuar normalisht nga shitësi në kohën e lidhjes së kontratës. Kur është fjala për sende që kanë çmim burse apo tregu, çmimi caktohet në bazë të listave të tregut të vendit ku do të bëhet dorëzimi, ose nga ato të vendit që është më afër tij. Në qoftë se çmimi është caktuar mbi bazën e peshës së sendeve, në rast dyshimi ai duhet të caktohet në bazë të peshës neto. Palët mund t’ia besojnë caktimin e çmimit një të treti, të emëruar në kontratë ose që mund të emërohet më vonë”.

²¹ Neni 674 i Kodit Civil parashikon: “Palët gjatë zhvillimit të bisedimeve për hartimin e kontratës, duhet të sillen me mirëbesim ndaj njëra-tjetrës. Pala që ka ditur, ose që duhet të dinte shkakun e pavlefshmërisë së kontratës dhe nuk ia ka bërë të ditur atë palës tjetër, detyrohet të shpërblejë dëmin që kjo e fundit ka pësuar, për shkak se besoi pa fajin e vet në vlefshmërinë e kontratës”.

formalisht i përmbushte kriteret për të përftuar një kredi të butë. Në mbështetje të këtij shkakui ankimi, subjekti i rivlerësimit parashtron se:

a) kërkesa e parë për kredi është bërë më datë 06.12.2006 – sipas *e-mail*-eve të printuara – dhe jo më datë 28.12.2010 kur është përcjellë emri nga Gjykata e Lartë për trajtim me kredi lehtësuese. Mangësitë në arkivimin dhe ruajtjen e dokumentacionit nga zyrat e protokollit të institucioneve shtetërore nuk mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit;

b) kredia është përfituar për shkak të funksionit të gjyqtarit dhe jo sikurse e shpreh Komisioni, në funksionin e kryetarit të Unionit të Gjyqtarëve apo të të qenit ekspert në angazhime të ndryshme²²;

c) aneksi i kontratës paraprake të shitjes të datës 22.03.2011 [i vërtetuar me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.03.2011], ndërmjet palës shitëse E. H. dhe palës blerëse Ervin Metalla dhe E. M. nga ana tjetër, parapriu marrëveshjen me Bankën Alpha dhe z. E. M. [nëpërmjet kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol.], datë 11.04.2011, “Për ndryshimin e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore nr. {***}, datë 25.07.2007 (Për zëvendësim debitor)”;

ç) nuk mund të konsiderohet cenim i kriterëve ligjore për të përfituar një kredi të tillë fakti i porositjes së një apartamenti në Tiranë, në kushtet kur qyteti i Durrësit është shumë afër Tiranës dhe se qëllimi i kredisë së butë nuk ndjek sendin, por ka për qëllim lehtësimin e përmbushjes së nevojës për strehim të funksionarit publik;

d) nuk qëndron konstatimi i Komisionit se në kohën e aplikimit për kredi, subjekti nuk kishte hequr dorë as nga kredia në Bankën Alpha dhe as nga apartamenti i banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, pasi kërkesa e subjektit për kredi të butë nuk është bërë më 28.12.2010, por që më datë 06.12.2006;

dh) nuk qëndron përfundimi i Komisionit se kontrata e datës 22.03.2011 është një veprim fiktiv, i simuluar. Kjo kontratë kishte për qëllim të garantonte zëvendësuesin e debitorit, kredimarrësin E. M., se pas përfundimit të procesit të legalizimit do të lidhej kontrata përfundimtare e shitjes dhe kalimit të të drejtës së pronësisë. Mbi bazën e kësaj kontrate, Banka Alpha pranoi zëvendësimin e debitorit në kontratën e kredisë;

e) Komisioni nuk ka arsyetuar pse i ka deklaruar të papranueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit se në momentin e çeljes së kredisë së butë ai plotësonte njërin nga kriteret pasi kishte nevojë për strehim, dhe nuk kishte në pronësi ndonjë banesë tjetër që të mund ta përdorte për strehim. Ai ka vazhduar të jetojë në apartamentin në rrugën “{***}” në Tiranë, por prej datës 11.04.2011 (data e cedimit të kredisë në Bankën Alpha) si huapërdorës i përkohshëm;

ë) nuk qëndron interpretimi i Komisionit lidhur me shkresën e OShEE-së nr. {***} prot., datë 05.07.2018, sipas së cilës është bërë ndryshimi i emrit të përdoruesit nga “E. H.” në “Ervin Metalla”, më datë 14.10.2011, cituar si provë që tregon fiktivitetin e aneksit të kontratës, pasi emri në kontratë kishte ndryshuar që pas blerjes së apartamentit, kohë në të cilën duhet të jetë bërë edhe shënimi përkatës. Për arsye të panjohura për subjektin, ky ndryshim u bë në vitin 2011, periudhë gjatë së cilës ende nuk kishte përfunduar procesi i legalizimit dhe i regjistrimit në ZRPP të apartamentit dhe as shitësi, as subjekti apo vëllai i tij, nuk figuronin *de jure* si pronarë të apartamentit;

²² Shih paragrafin 2.4.2.1., pika (iii), faqja 10 e vendimit të Komisionit.

f) Komisioni konfondon konceptin juridik të fiktivitetit (simulim absolut) me atë të simulimit (simulim relativ), si shkaqe për pavlefshmëri absolute të veprimeve juridike. Veprimi nuk mund të pretendohet njëkohësisht edhe si fiktiv, edhe si i simuluar, pasi:

- i) mbi bazën e kësaj kontrate, E. M. u bë titullar i së drejtës reale mbi pasurinë/apartament objekt i kësaj kontrate, që shërbeu edhe për kontratën e shkëmbimit të realizuar në vitin 2013;
- ii) destinacioni i kredisë nuk ka ndryshuar pasi ka financuar përmbushjen e nevojës për strehim. Kjo kredi vazhdon të deklarohet pranë ILDKPKI-së;
- iii) nuk ka bazë reale dyshimi për ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi i cili përbëhet nga një gamë e gjerë kontratash të ndryshme (fiktive) ndërmjet subjektit dhe bankave dhe shoqërive të ndërtimit me qëllim përfitimi nga trajtimi preferencial²³, pasi nuk ka asnjë mospërputhje ndërmjet veprimeve juridike, përmbajtjes së tyre dhe kohës së kryer apo deklaratave të palëve të përfshira në to;
- iv) nuk përmendet fakti që prona e blerë te shoqëria “{***}”ShPK me kredinë e butë u shkëmbye në vitin 2013 me apartamentin që u legalizua në emër të subjektit të rivlerësimit;
- vi) është deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2013 marrëveshja për shkëmbimin e pronave, e arritur në kushtet kur subjekti vazhdonte dhe jetonte në këtë apartament, pamundësisë financiare për të paguar tatimin për kalimin e të drejtës së pronësisë për efekt të kontratës së shitjes me blerësin E. M. dhe se vëllai, për interesa të tij, mund t’i jepte fund marrëdhënies duke përfituar banesën e porositur te shoqëria “{***}”ShPK;
- vii) mbi bazën e kësaj aneks–kontrate paraprake të shitjes, në vitin 2013 në origjinë, vëllai i subjektit të rivlerësimit ka përfituar të drejtën reale mbi apartamentin e ndërtuar nga shoqëria “{***}”ShPK dhe vazhdon ende të shlyejë kredinë pranë Bankës Alpha. Kjo pasuri rezulton ende e paregjistruar dhe shoqëria ka vendosur hipotekë mbi një pasuri të saj për të garantuar blerësin;

g) nuk është i bazuar në prova dhe në ligj qëndrimi i Komisionit se veprimet juridike fiktive të simuluar të kryera prej subjektit për qëllim përfitimi financiar nuk përputhen me sjelljet etike të gjyqtarit. Subjekti parashtron të njëjtin qëndrim të shtjelluar në paragrafin 23 të këtij vendimi. Sipas tij, kjo qasje e të njëjtit trup gjykues të Komisionit, sa i takon sjelljes jashtëgjyqësore, nuk ka qenë e njëjtë në rastin e një subjekti tjetër lidhur me kryerjen e ndërtimit e paligjshëm prej tij, por edhe raste të tjera të vendimmarrjes së Komisionit.

26. *Kronologjia e veprimeve juridike*

26.1. Në periudhën 2003 deri në fillim të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka banuar me qira në apartamentin nr. {***}, pall. {***}, në rrugën “{***}”, Tiranë, në pronësi të qiradhënësit E. H.. Ky i fundit ka depozituar më datë 15.09.2006 në institucionin përkatës formularin për legalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë edhe apartamentin dhënë me qira subjektit të rivlerësimit.

26.2. Referuar marrëdhënieve të subjektit të rivlerësimit me Bankën Alpha dhe me BKT-në për financimin me kredi në vitin 2007 dhe në vitin 2011 respektivisht, kronologjia kohore e veprimeve të kryera paraqitet në mënyrë të përmbledhur si vijon:

26.2.a. Më datë 18.07.2007, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e blerësit, ka nënshkruar kontratën paraprake të shitjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] me E. H. në cilësinë e shitësit, për shitjen e apartamentit nr. {***} dhe të garazhit të ndodhur në Tiranë, në rrugën “{***}”, pall. {***}. Sipas kontratës, kalimi i të drejtës së pronësisë do të realizohet përfundimisht pas

²³ Shih rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, pika 3.2, nënpika ii.

legalizimit të këtij objekti “të ndërtuar pa leje ndërtimi” dhe regjistrimit të tij në emër të shitësit në ZRPP Tiranë. Kontrata parashikon se kjo pasuri shitet kundrejt një çmimi prej 75.000 eurosh, negocimi i të cilit deri në hartimin e kontratës përfundimtare nuk mund të kalojë vlerën 70% të kësaj shume, që do të paguhet paraprakisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale, me marrjen e kredisë.

26.2.b. Më datë 26.07.2007, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e kredisë shumëqëllimore nr. {***}, datë 25.07.2007 [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], me Bankën Alpha, sipas së cilës banka i çel kredimarrësit kufirin e kredisë në shumën 58.500 euro. Po atë ditë, subjekti nënshkroi edhe kontratën e huas [nr. {***}], shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore [nr. {***}], sipas së cilës kredimarrësi ka përdorur shumën prej 55.000 eurosh nga kufiri i kredisë prej 58.500 eurosh për blerje apartamenti të ndodhur në Tiranë. Sipas kontratës, kredimarrësi ka paraqitur në bankë projektin e blerjes së apartamentit, me kosto të përgjithshme 75.000 euro. Kontributi i kredimarrësit është 20.000 euro (27%), ndërsa shuma 55.000 euro (73%) do të financohet nga banka, sipas kërkesës së kredimarrësit, për një afat 20 vjet, me normë interesi 5,7%.

26.2.c. Më datë 17.12.2007, subjekti i rivlerësimit dhe z. E. H. [nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol.], kanë deklaruar që çmimi i blerjes së objektit të kontratës, datë 18.07.2007 (paragrafi 26.2.a. më sipër), është 55.000 euro. Kjo shumë i është paguar shitësit nga blerësi nëpërmjet Bankës Alpha ditën e marrjes së kredisë pranë kësaj banke, më datë 02.08.2007.

26.2.ç. Më datë 18.06.2009, shitësi E. H. ka nënshkruar një deklaratë noteriale [nr. {***} kol., nr. {***} rep.] për vazhdimin e të gjithë procesit që ndiqet për legalizimin e pasurisë në emër të blerësit Ervin Metalla.

26.2.d. Më datë 28.12.2010, Bankës Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”) i është përcjellë lista e funksionarëve që përfitojnë kredi me kushte lehtësuese nga Gjykata e Lartë²⁴, midis të cilëve edhe subjekti i rivlerësimit Ervin Metalla.

26.2.dh. Më datë 22.03.2011, me nënshkrimin e një aneksi kontrate është bërë ndryshimi i palës blerëse të kontratës së shitjes [nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol.] të datës 18.07.2007, nga Ervin Metalla tek i vëllai E. M.²⁵, me parashikimin që ky i fundit ka zëvendësuar subjektin në cilësinë e debitorit ndaj Bankës Alpha, për kredinë e marrë për blerjen e apartamentit²⁶. Ky dokument rezulton të jetë përpiluar jashtë zyrës noteriale, i vërtetuar nënshkrimi me vërtetimin noterial [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] të datës 22.03.2011. Nga ana tjetër, ndryshe nga sa specifikohet në këtë aneks kontrate, zëvendësimi i debitorit (marrja përsipër e huas me Bankën Alpha nga E. M.) është kryer rreth 2 javë më vonë, më 11.04.2011, dhe jo përpara nënshkrimit të aneksit të kontratës paraprake, siç thuhet në nenin 3 të saj.

26.2.e. Më datë 11.04.2011²⁷, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e palës së tretë (“debitori i mëparshëm”) ka nënshkruar kontratën [nr. {***}, datë 08.04.2011] “Për ndryshimin e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore nr. {***}, datë 25.07.2007 (për zëvendësim debitori)”, mes Bankës Alpha nga njëra anë dhe kredimarrësve/debitorëve E. M. dhe Xh. M.

²⁴ Shkresa nr. {***} prot., datë 28.12.2010, nga Gjykata e Lartë drejtuar Bankës Kombëtare Tregtare.

²⁵ Në vazhdim të kontratës paraprake të shitjes nr. {***} dhe deklaratës noteriale nr. {***}.

²⁶ Nëpërmjet këtij akti, shitësi merrte përsipër që në rast se apartamenti objekt i kontratës legalizohej në emër të tij, kontrata përfundimtare e shitjes do të lidhej me blerësin E. M., i cili ka zëvendësuar debitorin në Bankën Alpha. Nëse legalizimi realizohej në emër të blerësit fillestar Ervin Metalla, ky i fundit detyrohet të lidhë kontratën përfundimtare të shitjes me E. M..

²⁷ Nr. {***} rep., nr. {***} kol.

dhe pala e katërt, “dorëzanësit”, N. M. dhe Sh. M.. Sipas kësaj kontrate, E. M. dhe Xh. M. kanë pranuar të marrin cilësinë e kredimarrësit duke zëvendësuar kredimarrësin/debitorin e mëparshëm Ervin Metalla, me të njëjtat kushte dhe detyrime të kontratës me kufi kredi shumëqëllimor nr. {***}/2007, në shumën 55.000 euro, me një tepricë prej 49.025 eurosh (neni 2 i kontratës).

26.2.ë. Më datë 18.04.2011, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar deklaratën noteriale [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] sipas së cilës deklaroi përmbushjen e kushteve për të përfituar kredi në kushte lehtësuese. Sipas kësaj deklaratë, subjekti nën përgjegjësinë e tij shprehet mbi vërtetësinë e thënies në lidhje me plotësimin e kushteve të parashikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave (në vijim “VKM”) nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe të funksionarëve politikë”, të ndryshuar, se nuk ka në pronësi pasuri të paluajtshme në vendin e ushtrimit të detyrës.

26.2.f. Më datë 30.06.2011, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje ndërtimi [me nr. {***} rep., nr. {***} kol.] me firmën ndërtimore “{***}”ShPK, për prenotimin e një apartamenti me sipërfaqe 81,8 m² në Durrës. Sipas kontratës, subjekti i rivlerësimit [porositësi] ka parapaguar *cash* jashtë zyrës noteriale këstin e parë prej 2.500.000 lekësh. Këstin e dytë prej 5.000.000 lekësh, pala porositëse [subjekti i rivlerësimit] pranon ta paguajë menjëherë pas *marrjes së kredisë bankare*.

26.2.g. Më datë 29.09.2011, tre muaj më pas, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e kredisë bankare [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], me BKT ShA (Dega Durrës) në total kreditimi të shumës 5 milionë lekë. Në cilësinë e dorëzanësit paraqitet përsëri vëllai, z. E. M., dhe bashkëshortja e tij (znj. Xh. M.). Sipas kontratës, shuma e kredisë prej 5 milionë lekësh do të përdorej për likuidimin e vlerës së mbetur të çmimit të blerjes së apartamentit dhe do të transferohej nga llogaria e kredisë në favor të *shitësit* të objektit të kredituar – shoqërisë “{***}”ShPK – me transfertë bankare nëpërmjet BKT-së. Në të njëjtën ditë, më 29.09.2011, është nënshkruar edhe kontrata e hipotekimit të apartamentit me sipërfaqe 55,8 m² në Tiranë dhe të shtesës së ndërtesës me hipotekues z. E. M. (dhe miratimi për nënshkrimin e këtij akti nga bashkëshortja e tij, znj. Xh. M.), në favor të BKT-së, Dega Durrës, për të siguruar kthimin e kredisë së marrë nga kredimarrësi Ervin Metalla, në shumën totale 5 milionë lekë.

26.2.gj. Më datë 21.10.2011, subjektit të rivlerësimit i ka kaluar nëpërmjet bankës shuma prej 4.950.000 lekësh, nga e cila ka transferuar shumën në vlerën 4.900.000 lekë në llogarinë e shoqërisë “{***}”ShPK, në referencë të kontratës [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], datë 30.06.2011. Nga dokumentacioni i mbledhur gjatë hetimit administrativ në Komision, e konkretisht, nga nxjerrja e llogarive bankare të shoqërisë “{***}”ShPK nga BKT në datën 25.01.2018 dhe të z. Ervin Metalla pranë BKT-së, rezultojnë se në harkun kohor prej 48 orësh, fondi i kredisë ka lëvizur nga subjekti i rivlerësimit te dy shoqëri ndërtimi dhe ka përfunduar te llogaria e të atit të subjektit, z. N. M., dhe në dispozicion të këtij të fundit, në fund të periudhës së deklaramit periodik vjetor [31.12.2011]. Konkretisht, rezultojnë transaksionet e mëposhtme.

- Më datë 25.10.2011 – transferimi i shumës nga llogaria e Ervin Metallës në llogarinë e shoqërisë “{***}”ShPK, në vlerën 4.900.000 lekë, me referencë kontratën nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 30.06.2011.
- Më datë 25.10.2011 – transferim shume nga shoqëria “{***}”ShPK te shoqëria “{***}”ShPK, në vlerën 4.900.000 lekë.
- Më datë 26.10.2011 – kthim shume nga shoqëria “{***}”ShPK te “{***}”ShPK, në vlerën 4.900.000 lekë. Shoqëria “{***}”ShPK, duke mos e konsideruar të përfunduar

marrëveshjen për blerjen e apartamentit me subjektin Ervin Metalla²⁸, i ka rikthyer fondet shoqërisë “{***}”ShPK.

- Më datë 27.10.2011 – transferim nga llogaria e shoqërisë “{***}”ShPK te llogaria e z. N. M. (babai i subjektit të rivlerësimit), me përshkrimin “Kthim borxhi”, në vlerën 4.900.000 lekë. Fondet në fjalë rezultojnë të kenë qenë në llogarinë e z. N. M. dhe në pronësi të subjektit të rivlerësimit më datë 31.12.2011 (shih më poshtë paragrafin 34).

26.2.h. Më datë 20.04.2012, Ervin e N. Metalla “në cilësinë e ceduesve”, B. G. në cilësinë e huadhënësit dhe B. K. në cilësinë e huamarrësit kanë nënshkruar një akt marrëveshje për shuarjen e detyrimeve me përtëritje midis tyre. Vlen të theksohet se të gjitha këto detyrime përkojnë me shumën prej 5.000.000 lekësh dhe që babai i subjektit të rivlerësimit, N. M., rezulton të ketë shitur në prill 2012 një pronë të paluajtshme, ndërsa blerësi të ketë paguar/shlyer 62% të vlerës së një prone, 20 muaj përpara shitjes. Po ashtu, subjekti rezulton të ketë shlyer pagesën e kështit prej 5.000.000 lekësh për një apartament të cilin *nuk e kishte porositur ende* te shoqëria “{***}”ShPK. Më konkretisht, sipas kontratës me përtëritje:

- B. K. – administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë “{***}”ShPK, e konsideron të paguar kështin prej 5.000.000 lekësh, për rezervimin e një apartamenti në rrugën “{***}”, dakordësuar tri ditë pas kësaj aktmarrëveshjeje (shih 26.2.i dhe 26.2.k më poshtë) me kontratën paraprake të sipërmarrjes datë 23.04.2012 dhe me kontratën përfundimtare [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], datë 31.12.2012, me palë shoqërinë “{***}” ShPK dhe z. Ervin Metalla, me objekt një apartament me sipërfaqe 96,43 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë;
- B. G. e konsideron të shlyer huan që B. K., si individ, kishte ndaj tij në vlerën prej 5.000.000 lekësh, sipas kontratës së huas së datës 07.04.2010;
- N. M. e konsideroi të shlyer parapagesën e një pjese të çmimit për blerje toke, të cilën shitësi (N. M.) nuk e dispononte, nga blerësi B. G., në vlerën 5.000.000 lekë. Kontrata mes këtyre dy palëve për shitblerjen është nënshkruar 20 muaj më vonë, më datë 26.12.2013;²⁹
- kalimi i shumës 4.900.000 lekë nga N. M. tek Ervin Metalla u konsiderua i ezauruar. Sipas deklarimeve të subjektit, fondet deri në këtë moment, ishin në pronësi të Ervin Metallës, kaluar përkohësisht në llogari të N. M.. Fondet në vlerën 4.900.000 lekë qëndruan përgjatë gjithë kësaj kohe në llogarinë e N. M..

26.2.i. Më datë 23.04.2012, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}”ShPK kanë nënshkruar revokimin e kontratës së sipërmarrjes [me nr. {***} rep, nr. {***} kol.] për një apartament në Durrës dhe shoqëria “{***}”ShPK i ka kthyer subjektit të rivlerësimit vlerën 2.500.000 lekë (referuar mandatarkëtimit të administruar nga Komisioni). Po atë ditë, subjekti i rivlerësimit ka lidhur një kontratë paraprake sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}”ShPK për një apartament me sipërfaqe 96,43 m², të ndodhur në Tiranë. Zgjidhja e kontratës me shoqërinë “{***}”ShPK për apartamentin në Durrës është dakordësuar me mirëkuptim midis palëve që në muajin shtator 2011³⁰.

26.2.j. Më datë 31.12.2012, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën përfundimtare të sipërmarrjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] me shoqërinë “{***}”ShPK, me objekt blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 96,43 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në vlerën 7.500.000 lekë.

²⁸ Referuar korrespondencës mes shoqërisë “{***}” ShPK dhe Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave më datë 29.01.2018. Fondet janë rikthyer në llogarinë e shoqërisë “{***}” ShPK më 26.10.2011.

²⁹ Nr. {***} rep., nr. {***} kol., me objekt tokë arë + truall, me sipërfaqe totale 7.500 m², të ndodhur në fshatin Metallë-Durrës, çmimi i kontratës 8.000.000 lekë.

³⁰ Shih deklaratën e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 29.01.2018, në përgjigje të korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

26.2.k. Më datë 20.12.2013, me nënshkrimin e aktmarrëveshjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] me pëlqimin e shoqërisë “{***}” ShPK, Ervin dhe E. M. kanë rënë dakord të shkëmbejnë apartamentet mes tyre. Si rrjedhojë, pasuria e legalizuar dhe e regjistruar në ZVRPP Tiranë në pronësi të subjektit të rivlerësimit, që konsiston në apartamentin dhe garazhin [fillestar] të cilin e kishte blerë sipas kontratës paraprake të shitjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] të datës 18.07.2007 nga shitësi E. H. [blerës Ervin Metalla], ndodhur në rrugën “{***}”, pall. {***}, Tiranë, mbetej në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Në të njëjtën kohë, sipas marrëveshjes në fjalë (20.12.2013), apartamenti objekt i kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.12.2012, në rrugën “{***}”, i kalonte në pronësi E. M. pas regjistrimit në ZRPP.

27. Kontrata e kredisë me Bankën Alpha

27.1. Gjatë procesit të hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit të datës 22.02.2018³¹, subjekti i rivlerësimit ka thënë se oferta nga E. H. për të blerë këtë apartament, në fillim të verës së vitit 2007, konsistonte në një çmim të përgjithshëm prej 55.000 eurosh. Sipas subjektit, për të përfituar prej saj dhe në pritje të miratimit të kredisë me kushte lehtësuese, ai ka negociuar me Bankën Alpha (Dega Durrës) për të marrë një kredi, e cila nuk financonte më tepër se 70% të vlerës së projektit. Në kushtet kur subjekti nuk kishte mundësi të financonte diferencën prej 30%, në nenin 2 të kontratës paraprake të shitjes u parashikua se çmimi i shitblerjes do të ishte 75.000 euro, dhe që deri në hartimin e kontratës përfundimtare nuk do të ndryshonte nën 70% të çmimit³². Banka Alpha procedoi me disbursimin e kredisë në shumën prej 55.000 eurosh mbi bazën e kësaj kontrate paraprake.

27.2. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të mos të ndalet në vlerësimin e karakterit ngushtësisht civil të kontratave dhe deklaratës noteriale për marrëdhëniet mes palëve, duke pasur parasysh që procesi i rivlerësimit ka natyrë administrative dhe ka për objekt deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit në raport me procesin e rivlerësimit për kriterin e kontrollit të pasurisë. Pa paragjykuar vlerën e kontratës së datës 18.07.2007, ndryshimi i një kushti themelor të kontratës, vetëm për t’iu paraqitur bankës në funksion të përfitimit të kredisë dhe jo qëllimit të vetë palëve, përmban elemente të fiktivitetit³³, pasi marrëveshja e palëve kontraktore nuk ka pasur qëllim që të sjellë pasojat juridike të ligjshme. Analiza e fakteve tregon që palët kanë pasur qëllim shmangien e zbatimit të normave ligjore që rregullojnë përfitimin e kredive bankare. Në këtë këndvështrim, duke pasur parasysh nga njëra anë qëllimet dhe veprimet e pranuar prej vetë subjektit të rivlerësimit që konsistonin në kryerjen e veprimeve juridike të caktuara, vetëm në shërbim të përfitimit të kredisë, duke aplikuar pranë një banke të nivelit të dytë në qytetin ku ai kryente funksionin e kryetarit të gjykatës dhe njëhej si i tillë, dhe nga ana tjetër, qëllimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve që ndër të tjera, është *rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë*, veprimet e subjektit të rivlerësimit, parë së bashku me veprime të tjera të cilat shtjellohen më poshtë, përbëjnë zgjedhje të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë. Në këtë vlerësim, trupi gjykues ka parasysh që nga vetë deklaratata e subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e datës 02.03.2018, rezulton se

³¹ Përgjigjja e subjektit kthyer më 02.03.2018, nëpërmjet postës elektronike.

³² Neni 2 “Çmimi i shitjes” – “Kjo pasuri shitet nga shitësi dhe blëhet nga blerësi kundrejt një çmimi prej 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) euro. Ky çmim, negociimi i të cilit deri në hartimin e kontratës përfundimtare nuk mund të kalojë vlerën prej 70% të shumës së sipërcituar, do të paguhet paraprakisht nga blerësi, jashtë kësaj zyre, me marrjen e kredisë prej këtij të fundit, duke bërë të mundur pagesën me bankë”.

³³ Neni 92 i Kodit Civil parashikon: “[...] Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasojat juridike (fiktive ose të simuluar)”.

shitësi dhe blerësi ranë dakord të deklaronin në kontratën e datës 18.07.2005 [nr. {***}] vlerën prej 75.000 eurosh, me qëllim mbulimin e plotë të çmimit real të shitjes prej 55.000 (që përbën edhe 73% të vlerës që mbulon kredia e akorduar nga Banka Alpha). Kontributi i kredimarrësit, sipas kontratës së huas nr. {***}, datë 25.07.2007, do të ishte 20.000 euro – vlerë të cilën subjekti nuk kishte në plan apo mundësi financiare³⁴ ta paguante. Për pasojë, kontrata paraprake e shitjes dhe ajo e kredisë shumëqëllimore e bindin trupin gjykues se sjellja e subjektit të rivlerësimit në gjetjen e shkaqeve të paligjshme në hartimin e kontratave³⁵ dhe përdorja e këtyre kontratave si mjete për të shmangur zbatimin e normave për përfitimin e kredisë bankare, bie ndesh me pritshmëritë nga një magjistrat në funksion të gëzimit të besimit të publikut. Çmimi prej 75.000 eurosh i vendosur në kontratën paraprake, ka përbërë një shifër të përlogaritur nga palët me qëllim përshtatjen me kushtet e bankës për financimin e kredisë prej 55.000 eurosh. Ky përfundim mbështetet edhe nga përcaktimi në kontratën paraprake (18.07.2007) që vlera minimale e shitjes nuk mund të jetë nën 70% të vlerës prej 75.000 eurosh.

27.3. Ndërsa marrëdhënia mes bankës dhe subjektit mbetet për t'u diskutuar nga palët kontraktore dhe vendosur prej tyre, trupi gjykues i Kolegjit çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se mungon interesi publik pasi bëhet fjalë për një marrëdhënie juridike private ndërmjet qytetarit Ervin Metalla dhe bankës, nuk qëndron në rrethanat konkrete. Trupi gjykues thekson se mbetet fakt i padiskutueshëm që subjekti i rivlerësimit, në vitin 2007, ndërsa ishte kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës³⁶, nënshkroi një kontratë huaje (nr. {***}, datë 25.07.2007) me Bankën Alpha në të njëjtin qytet ku ushtronte detyrën, sipas së cilës deklaronte se si kredimarrës do të përballonte 27% të një çmimi fiktiv, të cilin nuk kishte në plan dhe mundësi ta përballonte. Banka ka përlogaritur vlerën e kredisë në shumën 55.000 euro, referuar raportit 73% të vlerës 75.000 euro, pavarësisht parashikimeve në nenin 2 të kontratës paraprake të shitjes, të riprodhuar në poshtëshënimin nr. 32. Subjekti ishte kryetari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor në qytetin ku dega përkatëse e bankës funksionon, ndërsa prona objekt kredie gjendej në një qytet tjetër. Për rrjedhojë, në qytetin ku subjekti kryente detyrën, individit dhe funksioni (kryetar gjykate) ndërthuren. Për këto arsye, parë nga këndvështrimi i vlerësimit të veprimeve të gjyqtarëve nga një vëzhgues i thjeshtë³⁷, ky pretendim i subjektit bie ndesh me perceptimin e përshtatshmërisë në sjellje në jetën private që pritet nga një gjyqtar.

27.4. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit që kjo praktikë sjelljeje e palëve kontraktore parashikohet edhe nga neni 707 i Kodit Civil, po ashtu nuk qëndron. Kjo dispozitë e Kodit Civil u referohet rasteve kur palët nuk e kanë caktuar çmimin, në mungesë të ndonjë akti të organeve kompetente dhe duke prezumuar dëshirën e tyre për t'iu referuar çmimit të caktuar normalisht nga shitësi në kohën e lidhjes së kontratës. Në rastin konkret, sikurse është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, palët kanë qenë të ndërgjegjshme dhe kanë rënë dakord që çmimi real i shitjes do të ishte 55.000 euro; më pas kanë proceduar me nënshkrimin e kontratës paraprake me çmimin në vlerën 75.000 euro dhe kanë paraqitur këtë vlerë me qëllim që çmimi prej 55.000 eurosh të mbulohej tërësisht nga kredia.

³⁴ Shih deklarinin e subjektit të datës 02.03.2018, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit të datës 22.02.2018.

³⁵ Kodi Civil, neni 677 "Shkaku i paligjshëm", parashikon: "Në një kontratë, shkaku ligjor është i paligjshëm kur vjen në kundërshtim me ligjin, rendin publik, ose kur kontrata bëhet mjet për të shmangur zbatimin e një norme".

³⁶ Emëruar kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. {***}, datë 11.11.2005 - <http://klgj.al/component/k2/vendim-nr-183-dat%C3%AB-11112005>

³⁷ Shih "Vlera 4", Sjellja e përshtatshme dhe dukja e saj në https://www.unodc.org/documents/nigeria/publications/Otherpublications/Commentry_on_the_Bangalore_principles_of_Judicial_Conduct.pdf. Paragrafi 111, ndër të tjera: "[...] Më shumë rëndësi ka jo çfarë bën apo nuk bën një gjyqtar, por çfarë mendojnë të tjerët që ka bërë apo është në gjendje të bëjë [...]".

27.5. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e tjera të subjektit që lidhen me marrëdhënien e tij me bankën si gjatë nënshkrimit të kontratave në vitin 2007, ashtu edhe në vitet vijuese 2011 dhe 2017, janë përtej çështjes në diskutim dhe nuk ndryshojnë faktin që kontrata paraprake iu dorëzua bankës me çmim të pavërtetë dhe që vetë subjekti mori përsipër detyrime që nuk kishte asnjë qëllim t'i shlyente (27 për qind të çmimit). Veprimet e tij nuk përputhen me sjelljen etike që një gjyqtar pritët të ketë dhe që duhet të demonstrojë si gjatë ushtrimit të detyrës së tij, ashtu edhe jashtë veprimtarisë gjyqësore, duke marrë në konsideratë autoritetin dhe reputacionin që subjekti i rivlerësimit përfaqëson.

27.6. Lidhur me pretendimet e subjektit që lidhen me mungesën në vendimin e Komisionit të çështjeve konkrete që trajtojnë standarde të shtjelluara nga GjEDNj-ja, pavarësisht se në vendim nuk citohen çështje konkrete të jurisprudencës, në analizën dhe konstatimet e mësipërme trupi gjykues pati parasysh përgjegjësinë e gjyqtarëve që edhe në jetën jashtëgjyqësore të jenë të vëmendshëm për të mos cenuar autoritetin e pushtetit gjyqësor. Ky parim parashikohet ndër të tjera në Kodin e Etikës Gjyqësore³⁸ të miratuar nga gjithë gjyqtarët e Republikës së Shqipërisë në vitin 2006, por edhe në standardet ndërkombëtare të sjelljes gjyqësore, përfshirë “Parimet e Bangalores” mbi sjelljen e gjyqtarëve dhe Komentarin e botuar nga UNODC³⁹. Kjo çështje është trajtuar gjerësisht edhe në paragrafët 41-45 të vendimit.

28. *Lidhur me aplikimin dhe përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese*

28.1. Me ndryshimet e kryera më 29.12.2008, VKM nr. 600/2007, përfshiu edhe gjyqtarët në kategorinë e funksionarëve publikë për të cilët Këshilli i Ministrave merrte përsipër diferencën përtej normës së interesit prej 4%. Më datë 28.12.2010, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë përfshirë për herë të parë në grupin e përfituesve, bashkë me 13 gjyqtarë të tjerë, siç rezulton nga shkresa [nr. {***} prot.] dërguar BKT-së nga kryetarja e Gjykatës së Lartë.

28.2. Pas krijimit të mundësisë ligjore më 28.12.2010, trupi gjykues vëren se është me rëndësi rrjedha e veprimeve juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit për përfitimin e kredisë në kushte lehtësuese dhe marrëdhënies me BKT-në, përshkruar në paragrafët 26.2.dh deri në 26.2.k më sipër. Analiza e marrëdhënies së subjektit me dy shoqëritë e ndërtimit, shoqërinë “{***}”ShPK dhe “{***}”ShPK, në vijim të kësaj kontrate kredie, janë trajtuar në paragrafët vijues të këtij vendimi.

28.3. Siç është konstatuar më sipër, në paragrafët 28.1 dhe 28.2, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ai ka aplikuar për kredi me kushte lehtësuese që në fundin e vitit 2006 (06.12.2006), nuk mbështetet në prova. Rrethanat që i paraprinë aplikimit për kredi të butë nga subjekti i rivlerësimit bazohen në ndryshimet që ka pësuar VKM-ja nr. 600/2007⁴⁰. Ky akt nënligjor i parashikoi gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit si subjekte përfituese me VKM-në ndryshuese nr. 1714, datë 29.12.2008. Sipas këtyre ndryshimeve të fundit, subjekteve përfituese, gjatë kohës së ushtrimit të detyrës, nëse kishin nevojë për strehim, u lindte e drejta të kërkonin trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti për blerje banese në vendin e ushtrimit të detyrës, konkretisht në territorin e rrethit ku ndodhet selia administrative e organit ku subjekti kryen funksionin a ushtron detyrën. Për pasojë, nga

³⁸http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf, miratuar nga Konferenca Gjyqësore më 08.12.2006. Rregulli 15: “[...]Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor, ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore [...]”.

³⁹ Akronim për organizatën United Nations Office on Drugs and Crime – Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin.

⁴⁰ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2007/126/c378b277-222e-4564-bd43-c6e6bfc866a1>.

korrespondenca e Komisionit me KLD-në⁴¹, Ministrinë e Drejtësisë⁴² dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës⁴³, rezulton që pretendimi i subjektit për kërkesë nga ana e tij që në vitin 2006, nuk gjen pasqyrim në dokumentacionin e administruar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

28.4. Rregullat e VKM-së nr. 600/2007 detajohen në udhëzimin nr. 6257, datë 2.9.2008, të ministrit të Punëve Publike dhe ministrit të Financave “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuar nga shteti”, i ndryshuar. Sipas këtij udhëzimi, “[...] Banka akordon kredinë për subjektin që ka përfituar sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.9.2007, vetëm për blerje banese në qytetin ku subjekti ushtron veprimtarinë për të cilën ka përfituar të drejtën e subvencionimit [...]”⁴⁴.

28.5. Për sa rezulton më lart, trupi gjykues vëren se edhe korrespondenca ndërmjet institucioneve gjatë vitit 2009 (përgjigjja e dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe të vijara më tej përgjatë periudhës 2010-2011), administruar në fashikull, përkon me periudhën pas dhjetorit 2008 kur gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit u përfshinë shprehimisht në kategorinë e përfituesve të kredive me kushte lehtësuese, sipas ndryshimeve të VKM-së nr. 600/2007. Nga ana tjetër, përkundër pretendimit të subjektit se kur ai ka aplikuar për kredi në vitin 2006 nuk posedonte pronë, trupi gjykues vëren se plotësimi i dokumentacionit të kërkuar për aplikim i përket gjendjes faktike dhe juridike të tij në vitin 2011. Në deklaratën e datës 18.04.2011 (shih më sipër edhe paragrafin 26.2.ë), subjekti ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për të provuar se nuk ka pasur pasuri të paluajtshme në emër të tij apo të familjarëve në ngarkim të tij në qytetin e Durrësit, një javë pasi ia kishte kaluar kredinë te Banka Alpha vëllait të tij, z. E. M., dhe bashkëshortes.

28.6. Trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se qëllimi i VKM-së nr. 600/2007 është lehtësimi i kushteve të punës së funksionarëve të lartë shtetërorë nëpërmjet sigurimit të strehimit pranë vendit të punës. Për këtë qëllim, VKM-ja nr. 600/2007 parashikon si kushte thelbësore në dhënien e mundësisë për të përfituar nga programet e strehimit mungesën e pasjes në pronësi të pasurive të paluajtshme për strehim apo përgjithësisht mundësi të tjera financiare në formë aktiviteti ekonomik, likuiditete dhe mënyrë jetese që dëshmon për gjendje financiare të konsiderueshme ose që tejkalon kufirin e kredisë në emrin e funksionarit apo të personave të lidhur me të. Këto kushte thelbësore lidhen me elementet kyçe të qëllimit të ndihmës nga ana e buxhetit të shtetit, për përfitimin e mundësisë për strehim në vendin e punës, ku ndodhet selia administrative e organit ku një funksionar ushtron detyrën dhe me pamundësi financiare nga ana e funksionarit publik.

⁴¹ Shkresa nr. {***} prot., datë 21.03.2018, kthyer përgjigje shkresës nr. {***} prot., datë 08.03.2018, të KPK – nga verifikimi fizik i dokumenteve, si dhe nga kontrolli i regjistrit të korrespondencës së institucionit për vitin 2006, nuk rezulton kopje e kërkesës apo deklaratës së depozituar nga subjekti për rrethanat që mbështesin nevojën e trajtimit me kredi për strehim.

⁴² Shkresat nr. {***} prot., datë 03.05.2018, dhe nr. {***} prot., datë 10.05.2018, kthim përgjigjeje shkresës nr. {***}, datë 08.03.2018, të KPK-së. Sipas tyre, nuk ka të dhëna dhe procesi për evidentimin, gjetjen dhe vënien në dispozicion të dokumenteve arkivore subjekteve të interesuara, kërkon më shumë kohë.

⁴³ Shkresa nr. {***} prot., datë 15.01.2018, sipas së cilës në arkivin e kësaj gjykate për periudhën 2006-2011, nuk rezultoi të jetë regjistruar në protokoll apo gjendet fizikisht kërkesë e depozituar nga gjyqtari për trajtimin me kredi në kushte lehtësuese, apo kërkesë e gjykatës drejtuar BKT-së (të cilat nuk ndodhen fizikisht në arkivin e gjykatës). E vetmja korrespondencë e evidentuar është shkresa nr. {***} prot., datë 11.05.2009, e Ministrisë së Drejtësisë dhe shkresa nr. {***} prot., datë 13.05.2009 (kthim përgjigjeje) e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, akte këto që nuk ndodhen fizikisht në arkivin e gjykatës

⁴⁴ Parashikimi i shtuar me udhëzimin ndryshues nr. 6, datë 17.02.2011, hyrë në fuqi më datë 23.03.2011 (publikuar në FZ nr. 23, datë 23.03.2011) – shih <https://qbz.gov.al/eli/fz/2011/23/60d6b6b7-67be-45fc-8e36-1abb93a6a799>.

28.7. Në rastin konkret, subjekti i rivlerësimit ushtronte detyrën e gjyqtarit/kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nga viti 2005. Në mungesë të një pasurie të paluajtshme për strehim në qytetin e Durrësit, duke filluar data 29.12.2008 (data e hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 1714), subjekti i rivlerësimit ka pasur të drejtën të kërkojë trajtim me kredi me kushte lehtësuese nga shteti, në qytetin ku ushtronte detyrën, për shkak të ushtrimit të detyrës si gjyqtar. Këtë kredi subjekti e ka përfituar më datë 29.09.2011 (ditën e nënshkrimit të kontratës me BKT-në). Pavarësisht pretendimeve të subjektit se destinacioni i kredisë nuk ka ndryshuar, trupi gjykues çmon të nënvizojë se kjo kredi e fituar për të përmbushur nevojat për strehim të subjektit në vendin ku ushtronte detyrën, sipas pohimeve të subjektit, rezulton të jetë përdorur për të financuar investimin e tij fillestar në apartamentin që posedonte në Tiranë që në fillim të vitit 2008 (apartamenti nr. {***}, pall. {***}, rruga “{***}”). Në këtë dritë arsyetimi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, bazuar në largësinë e papërfillshme gjeografike mes Tiranës dhe Durrësit, që sipas subjektit përligj edhe veprimet e kryera prej tij pas përfitimit të kredisë nga BKT-ja, nuk përkon me qëllimin e legjislacionit të posaçëm për përfitimin e kësaj lloji kredie. Ky interpretim i tij gjatë procesit të rivlerësimit bie ndesh edhe me veprimet e tij në kohën në fjalë, në vitin 2011. Rezulton se pas deklaratës së kryer për efekt të përfitimit të kredisë, subjekti duhet të ketë qenë plotësisht i ndërgjegjshëm për kushtin gjeografik të përfitimit të kredisë – strehimin në qytetin ku ushtrohet funksioni – pasi:

- i) ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK (shih paragrafin 26.2.f më sipër) për një apartament në Durrës, më 30.06.2011;
- ii) ka nënshkruar kontratën e kredisë bankare me BKT ShA (Dega Durrës) për 5 milionë lekë, duke krijuar detyrime dorëzanie vëllait E. M. dhe ka hipotekuar apartamentin e këtij të fundit në favor të kreditorit, BKT Dega Durrës;
- iii) pas disbursimit të kredisë, ia ka kaluar fillimisht fondet shoqërisë “{***}” ShPK (për më pak se 24 orë).

28.8. Për sa më sipër, trupi gjykues vëren se pretendimi i subjektit se “kredia nuk ndjek sendin” nuk mbështetet në ligj dhe bie ndesh edhe me vetë interpretimin që subjekti rezulton të ketë pasur në momentin kur e ka përfituar atë. Kredia me kushte lehtësuese nga e cila ka përfituar subjekti i rivlerësimit, duke pasur për qëllim një përfitim të përcaktuar për funksionarë të përcaktuar dhe në kushtet e shtjelluara në aktet nënligjore që rregullojnë përfitimin nga kjo kredi nga njëra anë, dhe detyrimet që merr përsipër buxheti i shtetit në kushtet konkrete, nga ana tjetër, domosdoshmërisht lidhet me vendndodhjen e pasurisë pasi i shërben strehimit të funksionarit në vendin ku shërben. Referuar kushteve të parashikuara në VKM-në nr. 600/2007, të ndryshuar, kjo situatë lidhet specifikisht me banesën në vendin e ushtrimit të funksionit, pasi mospasja e strehimit në vendin e ushtrimit të detyrës dhe mungesa e pasurive të tjera ishin *conditio sine qua non* për përfitimin e kredisë.

28.9. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se prej vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ndodhej në marrëdhënie kontraktuale kredie me Bankën Alpha për financimin e projektit për blerje apartamenti në Tiranë. Kjo kontratë kredie ka qenë në fuqi edhe në datën 28.12.2010, kur kryetarja e Gjykatës së Lartë ka përcjellë listën e gjyqtarëve që do të trajtoheshin me kredi në kushte lehtësuese, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Marrëdhënia në fjalë me Bankën Alpha dhe shlyerja e kredisë ka vazhduar për pothuajse katër vjet, deri më datë 11.04.2011, kur është bërë zëvendësimi i tij në cilësinë e debitorit nga i vëllai [E. M.]. Në kohën e dorëzimit të deklaratës sipas së cilës subjekti plotësonte kushtet pasi nuk kishte pronë në Durrës, më 18.04.2011, subjekti i rivlerësimit kishte hequr dorë/ceduar nga kredia me kushte tregtare pranë Bankës Alpha.

28.10. Në ankimin e parashtruar, subjekti i rivlerësimit thotë: [...] duke qenë se unë nuk doja ta humbja shancin për këtë kredi me kushte lehtësuese, e cila ishte shumë e favorshme për

*mua, arrita një marrëveshje me Bankën Alpha dhe vëllain tim E. M., nëpërmjet kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2011 [...]. Kjo kontratë me bankën u parapri nga një aneks kontrate paraprake shitjeje e datës 22.03.2011 [...]*⁴⁵. Me fjalë të tjera, vetë subjekti i rivlerësimit pranon se veprimet e kryera për cedimin e kredisë dhe nënshkrimi i aneksit të kontratës paraprake të shitjes janë ndërmarrë vetëm për të plotësuar kushtet për të përfituar kredinë me kushte lehtësuese. Kjo aktmarrëveshje ka krijuar pasojën “në dukje” të dëshiruar për subjektin e rivlerësimit që në momentin e aplikimit për kredi me kushte lehtësuese të rezultonte se nuk kishte asnjë pasuri të paluajtshme në pronësi apo akt që të provonte pronësinë, duke ceduar nga kredia tregtare për financimin e apartamentit në Tiranë. Në të njëjtën kohë, trupi gjykues thekson se aneksi i kontratës paraprake të shitjes i datës 22.03.2011 nuk rezulton të ketë krijuar pasoja për palën tjetër të përfshirë, z. E. M., përveç marrjes përsipër të detyrimeve me kushte kredie tregtare, ndërkohë që subjekti përfitonte nga kredia lehtësuese. Vetë subjekti i rivlerësimit ka vazhduar të posedojë pa ndërprerje⁴⁶ pasurinë objekt i aktmarrëveshjes – apartamentin e blerë nga shitësi E. H. në vitin 2007 në rrugën “{***}” – edhe pas nënshkrimit të aneksit të kontratës paraprake të shitjes (datë 22.03.2011) dhe cedimit të kredisë me Bankën Alpha në ngarkim të E. M. (datë 11.04.2011)⁴⁷. Bindja e trupit gjykues se palët nuk kanë synuar që ky akt të prodhonte realisht kalimin e pronësisë të z. E. M., siç pretendohet, bazohet edhe në faktin që kjo kontratë nuk është përpiluar përpara noterit dhe nënshkruar para tij, duke i veshur veprimet formën e kërkuar ligjore të përcaktuar nga nenet 750 dhe 83 të Kodit Civil⁴⁸ për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme. Rezulton se noteri në këtë rast ka kryer vetëm vërtetimin e nënshkrimit. Në kontrast, në rastin e nënshkrimit të kontratës paraprake të shitjes në vitin 2007, subjekti i rivlerësimit dhe shitësi, E. H., kanë vepruar duke i veshur veprimet formën e kërkuar ligjore, në kushtet kur procesi i legalizimit dhe i regjistrimit në ZRPP i kësaj pasurie në emër të blerësit nuk kishte përfunduar ende (ky proces përfundoi në vitin 2013).

28.11. Në këtë kuadër, trupi gjykues sjell në vëmendje edhe shkresën e OShEE-së që konfirmon se kontrata me këtë shërbim ka qëndruar në emër të subjektit prej datës 14.10.2011 (kur është bërë ndryshimi i emrit), si një fakt që plotëson bindjen mbi fiktivitetin e aneksit të kontratës. Ndërsa përdorimi dhe posedimi i apartamentit në [rruga “{***}”] Tiranë është pohuar nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ dhe konfirmuar edhe nga deklaratat e tij periodike vjetore, trupi gjykues vëren se kjo rrethanë faktike – kontrata me OShEE-në – mbështet bindjen e trupit gjykues mbi fiktivitetin e aneksit të kontratës si një veprim juridik i kryer nga palët pa pasur asnjë synim konkret apo pasojë për E. M.⁴⁹.

29. Lidhur me kontratat me shoqëritë e ndërtimit

29.1 Për sa u përket kontratave të sipërmarrjes me shoqërinë “{***}”ShPK dhe “{***}”ShPK, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të pabazuar qëndrimin e Komisionit se kontrata fiktive me shoqërinë “{***}”ShPK, për blerjen e një apartamenti në Durrës, është lidhur për të përfituar kredinë me kushte lehtësuese nga BKT-ja, pa qëllimin për ta përmbushur atë. Në vlerësimin e Komisionit, veprimet e mëpasshme të tërheqjes nga kontrata dhe fillimi i një marrëdhënieje me shoqërinë “{***}”ShPK për një apartament në Tiranë, dëshmojnë se subjekti i rivlerësimit synonte që, me shumën e përfituar nga kredia e butë, të

⁴⁵ Shih paragrafët 1.2.8 dhe 1.2.10 të ankimit.

⁴⁶ Shih paragrafin 1.2.30.5 të ankimit.

⁴⁷ Shtjelluar në rrjedhën kronologjike më sipër, në paragrafët 26.1 dhe 26.2 më sipër.

⁴⁸ Neni 750 parashikon: “Shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij Kodi, përndryshe është e pavlefshme”. Neni 83 parashikon: “Veprimi juridik për kalimin e sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohët, përndryshe nuk është i vlefshëm. Është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji [...]”.

⁴⁹ Shih përgjigjet e datës 02.03.2018 të pyetësorit të datës 22.02.2018 (pyetjet 1 dhe 5).

blinte një apartament në Tiranë. Komisioni thekson se kredia “e butë”, e marrë nga subjekti i rivlerësimit në BKT nuk është përdorur për qëllimin për të cilin është marrë dhe nga dosja nuk rezulton që banka të ketë qenë e informuar për këtë përdorim të huas përtej projektit thelb të kontratës.

29.2 Më konkretisht, lidhur me shkakun e ankimit që lidhet me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}”ShPK, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

a) kontrata me shoqërinë “{***}”ShPK nuk është fiktive, pasi në të kundërt ajo do të ishte zgjidhur menjëherë pas disbursimit të kredisë. Kontrata është zgjidhur më datë 23.04.2012, pas kthimit të këstit të parë, në vlerën prej 2,5 milionë lekësh të parapaguar nga subjekti më datë 30.06.2011;

b) nuk ka ndryshuar ndonjëherë destinacioni i kredisë së butë, pasi ka përmbushur nevojën për strehim të subjektit të rivlerësimit;

c) nuk ka mosdeklarim të likuiditeteve (në vlerën 4.900.000 lekë gjendje, më datë 31.12.2011), pasi kjo shumë ka pasur për destinacion financimin e apartamentit për strehim dhe se në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011 kjo shumë ka vazhduar të deklarohet si detyrim ndaj BKT-së dhe për rrjedhojë nuk mund të ketë deklarim të dyfishtë: edhe si detyrim, edhe si likuiditet;

ç) nuk ka ekzistuar asnjë përpjekje e tij për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë vlerat monetare në pronësi të tij, si dhe ka deklarim të plotë e të mjaftueshëm të pasurisë dhe deklarimi nuk ka pasur asnjë inkoherencë.

- 30.** Referuar rrethanave të faktit lidhur me veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në marrëdhënie me shoqërinë “{***}”ShPK, siç shtjellohet më sipër në paragrafin 26.2 nga dokumentet në fashikull dhe hetimi administrativ ka rezultuar se:

30.1. Më 30.06.2011, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar një kontratë sipërmarrje [nr. {***} rep, nr. {***} kol.] me shoqërinë “{***}”ShPK për prenotimin e një apartamenti banimi në qytetin e Durrësit, në vlerën 7.500.000 lekë. Sipas kontratës, këstin e parë në shumën 2.500.000 lekë porositësi e ka parapaguar *cash* jashtë zyrës noteriale, kurse këstin e dytë në shumën 5.000.000 lekë porositësi merr përsipër ta paguajë pas marrjes së kredisë bankare. Në fashikullin e Komisionit gjendet i administruar mandatarëkëtimi nr. {***}, datë 30.06.2011, ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” në vlerën 2,5 milionë lekë, arkëtuar nga Ervin Metalla me përshkrimin: “Për prenotim apartamenti sipas kontratës”.

30.2. Më datë 29.09.2011, tre muaj pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes me shoqërinë “{***}”ShPK, në favor të subjektit të rivlerësimit është aprovuar kredia me kushte lehtësuese pranë BKT-së, sipas kontratës së kredisë bankare me objekt disbursimin e kredisë prej 5.000.000 lekësh. Nga shuma e disbursuar në datën 21.10.2011 prej 4.950.000 lekësh në llogarinë e z. Ervin Metalla, është transferuar në datën 25.10.2011 vlera prej 4.900.000 lekësh nga ky i fundit te llogaria e shoqërisë “{***}”ShPK. Po në këtë datë, “{***}”ShPK, me kërkesë të porositësit⁵⁰ [subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla], e ka transferuar shumën në llogarinë e shoqërisë “{***}”ShPK, e cila i ka rikthyer fondet në llogarinë e shoqërisë “{***}”ShPK në datën 26.10.2011. Shoqëria “{***}”ShPK, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, i ka transferuar fondet në datën 27.10.2011 në llogarinë e z. N. M..

30.3. Më datë 23.04.2012, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria “{***}”ShPK kanë nënshkruar deklaratën noteriale [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] për revokimin e kontratës së sipërmarrjes të datës 30.06.2011 (paragrafi 30.1) dhe për pranimin nga sipërmarrësi të kthimit të shumës prej 7,5 milionë lekësh e parapaguar dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme. Sipas

⁵⁰ Referuar deklaratës së administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, datë 29.01.2018, në përgjigje të korrespondencës me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

deklaratës, vlera është kthyer plotësisht jashtë zyrës noteriale. Në fashikullin e Komisionit gjendet i administruar mandatarëkëtimi nr. {***}, datë 23.04.2012 ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}”ShPK në vlerën 2,5 milionë lekë, me përshkrimin “revokim kontrate nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 23.04.2012”.

30.4. Në përgjigjen drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave⁵¹, shoqëria “{***}”ShPK deklaroi se rreth fundit të muajit shtator 2011, në kohën që miratimi dhe disbursimi i kredisë ishin në proces, subjekti i rivlerësimit dhe shoqëria ranë dakord në parim, me mirëkuptim, për zgjidhjen e kësaj kontrate. Për këtë arsye, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit, pasi u disbursua kredia më datë 25.10.2011, në të njëjtën ditë shuma i kaloi shoqërisë “{***}”ShPK. Të nesërmen, më datë 26.10.2011, kjo shumë u kthye nga shoqëria “{***}”ShPK në llogarinë e shoqërisë “{***}”ShPK, pasi subjekti dhe shoqëria nuk kishin arritur një marrëveshje për blerje apartamenti. Me kërkesë të Ervin Metallës, më datë 27.10.2011, shuma kaloi në favor të babait të tij, z. N. M.. Ndërkohë që zgjidhja përfundimtare e kontratës së sipërmarrjes [nr. {***} rep, nr. {***} kol.] u ra dakord të kryhej pasi të paguhej çmimi i parapaguar prej 2,5 milionë lekësh, që u arrit më datë 23.04.2012.

31. Në “Deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë” (në vijim “deklarata e interesave privatë”) për vitin 2011, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

*Kredi me kushte lehtësuese e marrë nga BKT, në shumën 5.000.000 lekë, për 30 vjet, me interes vjetor 4% [...], sipas kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.09.2011, e cila së bashku me shumën 2.500.000 lekë, si shpërblim për cedimin e debisë, kanë shërbyer për pagesën e çmimit prej 7.500.000 lekësh për porositjen e një apartamenti në Durrës, kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2011.*

32. Sa më sipër, rezulton se subjekti dhe shoqëria e ndërtimit “{***}”ShPK ranë dakord për zgjidhjen e kontratës për apartamentin në Durrës në muajin shtator 2011, në më pak se 3 muaj pas nënshkrimit të saj (më datë 30.06.2011). Procesi i zgjidhjes së kontratës u konkretizua me transferimin e shumës së disbursuar të kredisë në kushte lehtësuese në llogarinë e N. M., më datë 27.10.2011 dhe u finalizua më datë 23.04.2012, pas kalimit të pagesës së këstit të parë të paguar (i cili ishte vendosur si kusht nga palët për finalizimin e zgjidhjes së kontratës). Veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit përkojnë me çfarë ka deklaruar ai vetë në pyetësin e datës 22.02.2018, në përgjigje të pyetjes: [...] *E keni revokuar ju kontratën e porosisë me firmën “{***}”ShPK pas disbursimit të kredisë me BKT-në?* (pyetja nr. 3), të cilës subjekti iu përgjigj më datë 02.03.2018: [...] *kam rënë dakord në parim me shoqërinë “{***}”ShPK që pas disbursimit të kredisë të mund të negocionim për zgjidhjen e kontratës [...] në mënyrë që të kisha mundësi të porosisja një apartament në Tiranë, ku edhe banoja ndërkohë [...].* Në analizë të këtyre rrethanave dhe pohimeve të vetë subjektit, trupi gjykues i Kolegjit krijon bindjen se kontrata me shoqërinë “{***}”ShPK është fiktive, pasi realisht asnjë nga palët e kësaj kontrate me dakordësi nuk ka përmbushur asnjë detyrim dhe nuk ka përfituar nga të drejtat. Kontrata rezulton të ketë pasur për qëllim vetëm plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese për sigurimin e strehimit në qytetin e Durrësit. Ky përfundim mbështetet në gjithë kronologjinë e veprimeve të ndërmarra nga subjekti para përfitimit të kredisë dhe ato që e pasuan atë, përfshirë:

i) kontratën me shoqërinë “{***}”ShPK më 30.06.2011, negociimi për revokimin e saj pak javë më pas;

⁵¹ *Bashkëlidhur shkresës nr. {***} prot., datë 01.02.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave drejtuar Komisionit në përgjigje të shkresës nr. {***} prot., datë 16.01.2018.*

ii) kontratën e sipërmarrjes/porosisë për apartamentin në Tiranë (me “{***}”ShPK) në të njëjtën ditë të revokimit të kontratës për apartamentin në Durrës dhe revokimi edhe i kësaj të fundit, duke i lënë barrë vëllait E. M. sërish detyrimet e ndërmarra prej tij, siç është shtjelluar në paragrafin 26.2.k më sipër, në datën 31.12.2013, që përkon me ciklin raportues të deklaratës së interesave periodikë vjetorë; dhe

iii) veprimet financiare të ndërmarra me kërkesën e subjektit për lëvizjen e fondeve për llogari dhe përfitim të tij 5 (pesë) herë në harkun kohor prej 48 orësh, nga 25.10.2011 deri në 27.10.2011. Si pasojë e këtyre veprimeve dhe lëvizjeve, subjekti rezulton të ketë disponuar në pronësi të tij shumën e kredisë së disbursuar.

33. Nga dokumentacioni në fashikull, rezulton se në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011, dorëzuar më 15.03.2012, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shumën 4,9 milionë lekë si likuiditet të përfutur, siç shpjegohet më sipër në paragrafin 31. Si subjekt deklarimi për efekt dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ndër vite, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte në ILDKPKI, në deklaratat e interesave privatë periodikë/vjetorë, çdo ndryshim të mundshëm të interesave privatë të vitit respektiv. Ky është edhe qëllimi i deklarimit të pasurive si koncept bazë⁵² në luftën kundër korrupsionit nga funksionarët publikë dhe materializuar në ligjin nr. 9049/2003. Në përshkrimin e seksionit “Ndryshimet e interesave privatë, pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme”⁵³ në deklaratën e interesave privatë periodikë kërkohet nga deklaruesit:

Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shtuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni, të çdo lloj pasurie, të paluajtshme dhe të luajtshme, likuiditete, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit.

Kjo rubrikë e deklaratës detajon detyrimin për zbatim të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003 që parashikon:

[...] Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].

34. Subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë deklaruar në seksionin e detyrimeve shumën prej 4937.527,71 lekësh, si detyrim për t’u shlyer ndaj bankës. Edhe në pretendimet e tij në shkaqet e ankimit, subjekti përqendrohet vetëm te natyra e kredisë si detyrim, duke zgjedhur të heshtë për faktin që kjo shumë ishte në disponim dhe përdorim të tij më 31.12.2011 dhe një muaj pas depozitimit të deklaratës periodike vjetore për vitin 2011, më 20.04.2012, vlera

⁵² Shih <http://www.oecd.org/corruption/anti-bribery/47489446.pdf>: “On the other hand, proper wealth monitoring is possible only when the declared information truthfully reflects all of the substantial income and assets, and fluctuations thereof.” Në shqip: “[...] kontrolli i plotë i pasurive është i mundur vetëm kur informacioni i deklaruar pasqyron me vërtetësi gjithë të ardhurat dhe pasuritë, si dhe ndryshimet e tyre tek ndodhin [...]”. Neni 1 i ligjit nr. 9049/2003: “[...] Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të legjitimitetit të burimeve të krijimit të saj, detyrimeve financiare për të zgjedhurit, nëpunësit publikë, për familjarët e tyre dhe për personat e lidhur me ta”.

⁵³ Shih faqen 3 të deklaratës periodike vjetore në: <http://www.ildkpi.al/formulet-e-deklarimit/>.

financiare e përfituar nga kredia u kthye përfundimisht në pronësi të subjektit, si rrjedhojë e marrëveshjes së përshkruar në paragrafin 26.2.gj më sipër. Pretendimi i subjektit mbi deklarinë në seksionin e detyrimeve vlen për kreditë kur në përputhje me qëllimin e përfitimit, nëse është rasti i sipërmarrjes, arkëtohen për llogari të ndërtuesit për të financuar punimet. Në rastin konkret, pretendimi i subjektit do të pranohej nëse kredia e disbursuar, në zbatim të kushteve të kontratës, do të shkonte dhe do të përdorej nga shoqëria e ndërtimit për qëllimin për të cilin ishte disbursuar – financimin e ndërtimit. Siç është shtjelluar më sipër, në paragrafin 26.2.gj dhe më pas, nga data 27.10.2011 kredia rezultoi gjendje në llogarinë e babait të subjektit, z. N. M., duke u trajtuar dhe prej vetë subjektit me tagrin e pronësisë (referuar aktmarrëveshjes së datës 20.04.2012). Për sa kohë fondet rezultojnë të mos kenë qenë të bllokuara (pa urdhër bllokimi nga autoritetet, financiare apo të drejtësisë, apo me urdhër nga vetë banka në zbatim të politikave të saj), në llogarinë e z. N. M., ato mund të përdoren në çdo moment.

35. Trupi gjykues vëren se në deklaratën e interesave privatë për vitin 2011, subjekti i rivlerësimit rezultoi të mos ketë deklaruar vlerën e likuiditeteve në shumën 4.900.000 lekë, aneksin e kontratës paraprake të shitjes së datës 22.03.2011 (shih nënparagrafin 26.2.dh) dhe veprimet e kryera të cilat kulmuan me përfitimin e kredisë, pas disbursimit të kësaj të fundit, nëpërmjet transaksioneve të shumëfishta të datës 21.10.2011 deri në datën 27.10.2011 (shih nënparagrafin 26.2.gj).

36. Në përmbledhje të gjithë sa më sipër, në analizë të veprimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë jobindëse dhe bien ndesh me ligjin dhe provat. Në këtë vlerësim, trupi gjykues pati parasysh analizën e pretendimeve të subjektit kundrejt fakteve dhe dokumentacionit në fashikull, përfshirë edhe faktin që subjekti ka zgjedhur të mos e njoftojë bankën për zgjidhjen e kontratës me shoqërinë e ndërtimit, gjatë kohës që kredia ishte në proces miratimi (shih paragrafin 30.4).

36.1. Subjekti pretendon se i) kërkesa për kredi me kushte lehtësuese daton më 06.12.2006, 4 (katër) vjet përpara se subjekti i rivlerësimit të rezultojë ta ketë përfituar realisht dhe ii) që kriteret ligjore nuk janë cenuar, pavarësisht porositjes së një apartamenti në Tiranë, megjithëse edhe ai vetë me veprimet e kryera më pas, rezultoi të ketë qenë i ndërgjegjshëm për kriterin gjeografik si kusht për financimin – siç provohet edhe nga plotësimi nga ana e tij e dokumentacionit për kredinë me kushte lehtësuese, me bazë një kontratë sipërmarrjeje për një apartament në qytetin ku ushtronte funksionin (Durrës).

36.2. Në kontrast me sa më sipër, trupi gjykues vëren se:

a) megjithëse fondi i kredisë u lëvrua për kompaninë e ndërtimit, në fakt mbeti në disponim të vetë subjektit dhe nuk u deklarua prej tij;

b) subjekti i rivlerësimit hoqi dorë formalisht nga pronësia e apartamentit një javë përpara se ai të vetëdeklaronte se plotësonte kushtet për të përfituar kredi me kushte lehtësuese, ndërkohë që vazhdoi të jetonte në të njëjtin apartament;

c) shitja e kësaj pasurie të vëllai nuk u provua, ndërsa aneksi i kontratës paraprake të shitjes nuk rezultoi të ketë pasur asnjë efekt mbi vëllanë, i cili e mori përsipër apartamentin dhe kredinë në kushte të disfavourshme financiare, ndërsa subjekti përfitoi kredi lehtësuese me normë interesi 4%.

36.3 Konstatimi i trupit gjykues të Kolegjit është në të njëjtën qasje me përfundimin e Komisionit. Si rrjedhojë, analiza e trupit gjykues rrëzon pretendimet e subjektit se Komisioni nuk ka arsytuar pse i ka deklaruar të papranueshme shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi vlefshmërinë e kontratës me shoqërinë “{***}”ShPK, si të pabazuara në fakte dhe në prova. Për sa u përket pretendimeve të subjektit që kundërshtojnë vlerësimin nga ana e Komisionit si

sjellje joetike të veprimeve të tij, kjo çështje është trajtuar gjerësisht në paragrafët 41-45 të vendimit.

37. Lidhur me shkakun e ankimit që lidhet me kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “{***}”ShPK, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:
- a) nuk ka qenë i nevojshëm apo i detyrueshëm depozitimi i kontratës paraprake me shoqërinë “{***}”ShPK, ndërkohë që është deklaruar rregullisht dhe është dorëzuar kontrata përfundimtare, duke qenë se këto dy kontrata kanë qenë hartuar brenda të njëjtit vit;
 - b) nuk rezulton të ketë mospërputhje në mënyrën e pagesës së apartamentit të porositur te shoqëria “{***}”ShPK, pasi detyrimi si blerës/porositës për pagimin e kështit të parë prej 5 milionë lekësh u shlye paraprakisht, duke u konsideruar i shuar me përtëritje në kuptim të nenit 508 të Kodit Civil;
 - c) statusi i pezullimit të shoqërisë nuk lidhet me ushtrimin e të drejtës së pronësisë dhe nuk kishte ndikim për blerësin;
 - ç) në konkluzion, nuk ekziston asnjë provë që ai ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose evidentuar në mënyrë të pasaktë “të vetmen pasuri në pronësi, posedim dhe përdorim.”⁵⁴ Nuk qëndron përfundimi i Komisionit se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë.

38. Referuar rrethanave të faktit lidhur me veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në marrëdhënie me shoqërinë “{***}”ShPK, trupi gjykues ka konstatuar se:

38.1. Subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar aktmarrëveshjen e datës 20.04.2012⁵⁵ në cilësinë e njërit prej ceduesve, me huadhënës B. G. dhe huamarrës B. K. dhe cedues tjetër N. M.. Sipas saj, subjekti i rivlerësimit deklaron se kërkon të porosisë blerjen e një apartamenti që po ndërtohet nga shoqëria sipërmarrëse “{***}”ShPK dhe ceduesi N. M. deklaron se shuma 4,9 milionë lekë gjendet në llogarinë e tij dhe është në pronësi të ceduesit Ervin Metalla. Shoqëria “{***}”ShPK, me lidhjen e kontratës së sipërmarrjes, do të lëshonte një mandatpagesë në shumën prej 5 milionë lekësh, si pjesë e çmimit për porositjen e blerjes së apartamentit prej porositësit/ceduesit Ervin Metalla.

38.2. Më pas, më datë 23.04.2012, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën paraprake të porosisë me shoqërinë “{***}”ShPK. Sipas kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit kërkon të zëvendësojë porosinë për blerjen e një apartamenti në Durrës nga shoqëria “{***}”me porosinë për blerjen e një apartamenti në Tiranë që po ndërtohet nga shoqëria “{***}”ShPK. Sipas kontratës, çmimi i apartamentit në Tiranë është i njëjtë me atë në Durrës, 7.500.000 lekë, kurse pagesa do të bëhet në dy këste: i pari, në shumën 5.000.000 lekë është paguar (sipas kushteve të kontratës me përtëritje), kurse kësti prej 2.500.000 lekësh do të paguhet brenda vitit 2012. Bashkëlidhur kontratës gjendet mandatarkëtimi nr. {***}, datë 23.04.2012, arkëtuar nga Ervin Metalla, shuma 5 milionë lekë, me shënimin: “Këst për ap., rruga “{***}”.

38.3. Më datë 31.12.2012, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar kontratën e sipërmarrjes [nr. {***} rep., nr. {***} kol.], me objekt blerjen e një apartamenti me çmim 7,5 milionë lekë me shoqërinë “{***}”ShPK. Sipas kontratës, çmimi është paguar para nënshkrimit. Kontrata shoqërohet me mandatarkëtimi në shumën 2,5 milionë lekë⁵⁶, me shënimin: “Kësti i fundit për ap. {***}.”

⁵⁴ Sipas ankimit të subjektit të rivlerësimit, paragrafi 1.4.7, faqe 23.

⁵⁵ Shih paragrafin 26.2.h më sipër, referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, fashikulli 3, faqja 315.

⁵⁶ Mandati mban nr. {***} dhe datën 20.12.2012, arkëtuar nga Ervin Metalla.

38.4. Me aktmarrëveshjen [nr. {***} rep., nr. {***} kol.] e datës 20.12.2013, pas legalizimit dhe regjistrimit të apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, në emër të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit së bashku me vëllanë E. M. dhe shoqërinë “{***}”ShPK (me cilësinë “dhënës pëlqimi”) kanë nënshkruar një marrëveshje që apartamenti në fjalë – me sipërfaqe 96,8 m² dhe një garazh me sipërfaqe 22,5 m² – të mbetet në pronësi të Ervin Metallës. Apartamenti i porositur nga subjekti si më sipër (nënparagrafi 38.1, 38.2 dhe 38.3) te shoqëria “{***}”ShPK kalon në pronësi të z. E. M., pas regjistrimit në ZRPP për shkak të vlerës përafërsisht të njëjtë, duke vazhduar pagimi i kredive përkatëse prej secilit nga palët.⁵⁷

38.5. Në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012 dhe për vitin 2013, në seksionin “Ndryshime të pasurive dhe burimit të krijimit”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar respektivisht:

*[...] Zgjidhje e kontratës së porosisë për blerje apartamenti me kredi, me nr. {***}/ {***}, dt. 30.06.2011 dhe lidhja e një kontrate të re sipërmarrjeje, për të njëjtën vlerë, me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31/12/2012. Vlera 7.500.000 lekë, pjesa në zotërim 100% [...].*

Dhe:

*[...] Apartament me sip. 96,8 m², së bashku me garazh me sip. 22,5 m², përkatësisht me nr. pasurie {***}, Regj. Hip. {***} dhe nr. pasurie {***}, Regj. Hip. {***}, ZK {***}, Tiranë [...], përfituar në shkëmbim të apartamentit sipas aktmarrëveshjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2013. Pjesa në %: 100% [...].*

39. Nga dokumentet në fashikull rezulton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave privatë për vitin 2012 nuk ka deklaruar veprimin juridik të kryer më datë 23.04.2012 për porosinë e apartamentit nga shoqëria “{***}”ShPK. Duke mbajtur në konsideratë arsyetimin në paragrafin 33 të këtij vendimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte veprimin e kryer për porositjen paraprake të apartamentit pranë shoqërisë “{***}”ShPK. Siç është shtjelluar hollësisht më sipër, në referim të ligjit dhe udhëzimeve të qarta të seksionit “Ndryshimet e pasurive dhe burimi i krijimit të tyre”, subjekti duhet të kishte përshkruar porosinë e apartamentit të “{***}”, në zbatim të detyrimit që rrjedh nga deklarimi periodik vjetor që kërkon të pasqyrohen vit pas viti interesat pasurore të subjekteve deklaruese dhe burimi i të ardhurave të përdorura⁵⁸.

39.1. Transaksionet ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}”vërtetohen me anë të mandatpagesave të lëshuara nga shoqëria. Ligji nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar⁵⁹, për zbatim të të cilit ka dalë udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave nr. 6915/2, datë 30.01.2012, “Mbi procedurat teknike për

⁵⁷ Në përgjigjet e datës 02.03.2018 të pyetësorit të datës 22.02.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi që shkëmbimi i pronave me të vëllanë, z. E. M., u bë duke qenë se ai [subjekti] banonte në atë apartament, lidhja e kontratës përfundimtare të shitjes do të kërkonte pagimin e tatimit mbi fitimin në vlerë të konsiderueshme për të cilën ai nuk kishte mundësi financiare dhe i vëllai kishte më shumë interes t'i jepej fund kësaj marrëdhënieje dhe të përfitonte banesën të “{***}” ShPK. Shih faqen 16, përgjigjen e pyetjes: “Kush është aktualisht gjendja e pronës?”.

⁵⁸ Shih poshtëshënimin nr. 53 më sipër. Në faqen 3 të deklaratës periodike vjetore përcaktohet: “[...] Përshkruani hollësisht ndryshimet (shtesa dhe pakësime) në: llojin, sipërfaqen, adresën ku ndodhen, momentin e kryerjes së veprimit, vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi, çmimin e blerjes, në mungesë të dokumenteve vlerën që keni shuar apo pakësuar, pjesën takuese që zotëroni të çdo lloj pasurie, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit [...]”.

⁵⁹ Ligji nr. 10491, datë 15.12.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7829, datë 1.6.1994, “Për noterinë”, i ndryshuar”.

derdhjen e pagesës së tjetërsimit në llogarinë bankare të noterit”⁶⁰, parashikon se me realizimin e kontratës, pala blerëse duhet të derdhë çmimin e tjetërsimit të pasurisë së paluajtshme në llogarinë e noterit. Kontrata firmoset nga të dyja palët vetëm pas kryerjes së kësaj procedure. Në zbatim të këtij akti nënligjor, pagesa e kësaj detyre të çmimit të apartamentit të porositur do të duhej të ishte kryer dhe të vërtetohej me transaksion bankar në llogarinë e noterit. Kësti parë i apartamentit është paguar në kushtet e shuarjes së detyrimeve, ndërsa kësti i dytë (20.12.2012) përpara hyrjes në fuqi të udhëzimit nr. 6915/2-2012. Trupi gjykues çmon se është detyrim i noterit të informojë palët mbi mënyrën e kryerjes së pagesave për transaksionet e kryera prej tyre pranë zyrave noteriale. Nga ana tjetër, subjekti nuk ka shpjeguar mospërputhjen e vlerës që i konsideron detyrimet e shuara me përtëritje prej 4.900.000 lekësh (shih kontratën e datës 20.04.2012, paragrafi 26.2.h) kundrejt vlerës prej 5.000.000 lekësh të cituar në mandatpagesë.

39.2. Kontrata e porosisë në datën 31.12.2012, rezulton të jetë nënshkruar gjatë kohës kur shoqëria “{***}”ShPK, duke qenë me statusin “e pezulluar”, e kishte të ndaluar kryerjen e veprimtarisë ekonomike, sipas udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në RSh”, i ndryshuar⁶¹. Në këtë rast, mungesa e dijenisë së këtij fakti, sikurse pretendon në ankim subjekti i rivlerësimit⁶², është shpjegim jobindës dhe i papranueshëm në rrethanat konkrete faktike. Transaksionet e shumëfishta të kryera nga subjekti me ortakun e vetëm të kësaj shoqërie si individ, me anën e kontratës me përtëritje (shih nënparagrafin 26.2.h më sipër ndër të tjera), përfshirja e familjarëve të tij në kuptimin e zgjeruar të fjalës (përfshirë babanë, vëllanë dhe një individ të tretë) në një marrëdhënie shumëpalëshe dhe lidhja e kontratave të porosisë apo dhe zëvendësimet mes tij dhe vëllait në marrëdhëniet e biznesit me këtë shoqëri dhe ortakun e saj të vetëm (B. K.) përgjatë tri viteve – 2011 deri në fund të vitit 2013 minimalisht – tregojnë një marrëdhënie të vazhdueshme dhe të qëndrueshme mes subjektit dhe këtij individi. Në dritën e këtyre fakteve, është vështirë të pranohet pretendimi i subjektit për padijeni apo neglizhencë në informimin e gjendjes operationale të kësaj kompanie. Trupi gjykues këtu ka parasysh edhe që subjekti, jurist dhe gjyqtar me përvojë, mund të informohej edhe nëpërmjet noterit për statusin e kompanisë.

40. Në ankim, subjekti i rivlerësimit parashtron se nuk ka kryer asnjë veprim që përbën sjellje joetike për një gjyqtar dhe hetimi për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit do të tregonte që sjellja jashtëgjyqësore, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni, konsiston në një kontribut të shtuar për sistemin e drejtësisë.
41. Në analizë të rrethanave të faktit dhe ligjit të zbatueshëm, trupi gjykues konstaton se ky pretendim i subjektit nuk qëndron dhe përfundimi i Komisionit është i drejtë. Siç është shtjelluar edhe më sipër, kredia në kushte lehtësuese është përfituar në shkelje të kriterëve ligjore. Jo vetëm që subjekti nuk e përdori kredinë për të siguruar strehimin në vendin e punës së tij, në Durrës, por sikurse është dëshmuar në hetimin dhe vendimin e Komisionit dhe siç rezultoi nga vlerësimi i kryer nga Kolegji, subjekti i rivlerësimit ndërmoi një sërë hapash dhe veprimesh juridike të shtjelluara gjerësisht më sipër, vetëm në funksion të plotësimit formal të kushteve të përfitimit të kredisë, përfshirë aneksin e kontratës paraprake të shitjes të datës 22.03.2011, kontratën fiktive për sipërmarrje ndërtimi me shoqërinë “{***}”ShPK për prenotimin e një apartamenti në Durrës, revokimin e së cilës e negocioi vetëm tre muaj pasi e nënshkroi, dhe lëvizjet financiare të kredisë fillimisht te shoqëria “{***}”ShPK, ndërsa destinacioni final rezultoi llogaria bankare e të atit, në disponim të vetë subjektit. Në këtë vlerësim, trupi gjykues sjell në vëmendje edhe faktin e pohuar nga vetë

⁶⁰ Hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare nr. 183, datë 31.12.2012, dalë nga shtypi më datë 17.01.2013 - <https://qbz.gov.al/eli/fz/2012/183/3e022946-2473-4775-b1f2-bed8a309d62e>.

⁶¹ Pika 44.1.5. e udhëzimit.

⁶² Shih paragrafin 1.4.6.4 të ankimit.

subjekti se ai asnjëherë nuk hoqi dorë nga përdorimi/posedimi i apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë.

42. Trupi gjyqësor i Kolegjit vlerëson se kjo mënyrë sjelljeje e subjektit të rivlerësimit tregon qasjen e tij në raport me respektimin e ligjit, zbatimin e cilit është detyra parësore e një gjyqtari, nëpërmjet vendimeve të dhëna, por jo vetëm. Sjellja jashtëgjyqësore e gjyqtarit, për shkak të rëndësisë që ka besimi i publikut tek integriteti dhe autoriteti i pushtetit gjyqësor, është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare që udhëzojnë shembujt më të mirë të sjelljes dhe integritetit. Më konkretisht, Kodi i Etikës së Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, në rregullin 15 përcakton: “Gjyqtari duhet të kryejë të gjitha veprimtaritë jashtëgjyqësore në mënyrë të tillë që ato të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tij, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore”.⁶³
43. Në komentarin e Parimeve të Bangalores për Sjelljen Gjyqësore, është trajtuar gjerësisht sjellja e gjyqtarëve në veprimtarinë jashtëgjyqësore duke e lidhur me elemente të dinjitetit, integritetit, paanësisë dhe reputacionit, ndër të tjera⁶⁴. Për sa i përket sjelljes së gjyqtarëve, në komentarin shtjellohet, ndër të tjera:

Paragrafi 108 – Kërkohej respektimi i rreptë i ligjit – Shkelja e ligjit nga një gjyqtar mund të dëmtojë reputacionin e funksionit si gjyqtar, të inkurajojë mosrespektimin e ligjit dhe të cenojë besimin e publikut në integritetin e vetë gjyqësorit [...]. Një gjyqtar është i detyruar të mbështesë ligjin. Ai ose ajo nuk duhet të vendoset në një pozicion konflikti në zbatim të ligjit. Çfarë të tjerët mund të shihet si një shkelje relativisht e vogël, te gjyqtari mund të tërheqë publicitetin dhe dëmtojë imazhin e gjyqtarit dhe të shtrojë pikëpyetje në lidhje me integritetin e tij/saj dhe integritetin e gjyqësorit.

Paragrafi 109 – Sjellja personale e një gjykatësi ndikon në të gjithë sistemin gjyqësor – Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe mbi integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjykatësi jo vetëm që duhet të jetë një “gjyqtar i mirë”, por edhe një “person i mirë”, edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjykatës jo vetëm që është zotuar t’u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të vërtetës mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t’i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe vetëbesimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkohej nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjykatës. Është sikur funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdolloj mënyre rolin gjyqësor dhe gjykatën.

⁶³ Kodi i Etikës Gjyqësore, neni 15. Shih:

http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf.

⁶⁴ https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf

Paragrafi 111 – Si mund të duket kjo në sytë e publikut – [...] *Ajo që ka më shumë rëndësi nuk është çfarë bën apo nuk bën një gjyqtar, por atë që të tjerët mendojnë se ka bërë gjyqtari ose mund të bëjë [...].*

44. Në Opinionin nr. 3 të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë (Consultative Council of European Judges {CCJE}), mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtueshme dhe paanshmërinë (Strasburg 19.11.2002), shkruhet: [...] *Në jetën shoqërore, gjyqtari duhet të sillet me dinjitet dhe korrektësi dhe të mbetet i vëmendshëm ndaj interesit publik. Brenda kuadrit të funksioneve të tij dhe në çdo akt profesional, ai duhet të frymëzohet nga vlerat që janë përtej interesimit personal, të pavarësisë dhe paanshmërisë [...]*⁶⁵.
45. Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një gjyqtar, i cili edhe jashtë orarit të punës duhet të kujdeset që sjellja e tij të jetë në të mirë të funksionit zyrtar që ushtron, të mos karakterizohet nga fiktiviteti dhe mashtrimi i çdo lloji⁶⁶. Ky përfundim i trupit gjykues gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit⁶⁷. Konkretisht, në çështjen e regjistruar në Kolegj me nr. 31/2018 (JR), trupi gjykues, në vlerësimin e tij [në paragrafët nr. 29 dhe 34] për fiktivitet lidhur me çmimin e vendosur nga palët në funksion të përfitimit të një kredie, dhe lidhur me përfitimin e një prone [në paragrafin nr. 50] në kushtet kur nuk përmbusheshin kriteret e vendosura nga një akt nënligjor (VKM), ka konstatuar shkaqe në të cilat gjen zbatim neni 61, pika 5, pasi subjekti ka cenuar besimin e publikut te drejtësia për shkak të kontratave fiktive për të përfituar kredi bankare, dhe për shkak të përfitimit të një pasurie në kushtet kur subjekti nuk përmbushte kriteret ligjore për përfitim.
46. Lidhur me pretendimin e subjektit në ankim *se ka shpjeguar bindshëm, në mënyrë të plotë dhe të saktë, pa ndërhyrje asnjë hap për të fshehur apo paraqitur në mënyrë të pasaktë burimin e ligjshëm të pasurisë së paluajtshme në pronësi, posedim dhe gëzim: apartament banimi dhe garazh, ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, si dhe nuk ka kryer deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë, trupi gjykues sjell në vëmendje kronologjinë e veprimeve të kryera – shtjelluar hollësisht në nënparagrafin 26.2 më sipër.*
47. Në analizë të deklarameve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i tij nuk qëndron, ndërsa konkluzioni i Komisionit mbështetet në ligj dhe prova. Konkretisht, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë së subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit është kontrolli i saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarameve të subjektit në deklaramat periodike dhe në deklaramen e rivlerësimit. Në çdo rast, subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete). Në zbatim të këtij parimi kushtetues, ligji nr. 84/2016 në nenin 61, pika 3 ka përcaktuar se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra jepet kur rezulton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kontrollin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të këtij ligji. Lidhur me deklaramet e subjektit në deklaramat ndër

⁶⁵ <https://rm.coe.int/16807475bb>, paragrafi 42.

⁶⁶ https://www.unodc.org/res/ji/import/international_standards/commentary_on_the_bangalore_principles_of_judicial_conduct/bangalore_principles_english.pdf.

⁶⁷ Shih vendimin nr. 22, datë 16.09.2019, në: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/11/Vendimi-B-Hoti-anonimizimi.pdf>. Shih konkluzionin e trupit gjykues në paragrafin 67, pikat 1 dhe 2: “[...]Nga vlerësimi tërësor i kriterëve të rivlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, bazuar në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sepse: 1. subjekti nuk mund të përfitonte [...], pasi nuk plotësonte asnjë nga kriteret e legjislacionit në fuqi të kohës [...]; 2. subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë kryer veprime juridike fiktive, me qëllim përfitimin e kredisë bankare për blerjen e pasurisë apartament [...]”.

vite, në deklaratën e rivlerësimit, deklaratimet e tij pranë Komisionit gjatë periudhës së hetimit administrativ, si dhe të dhënat e rezultuara nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar në dosje mbi pasurinë në pronësi, burimin e krijimit dhe vlerën e saj, dalin në pah pasaktësitë/pamjaftueshmëritë e deklaratave si vijojnë.

1. Subjekti i rivlerësimit ka qenë i pasaktë ndër vite lidhur me vlerën e apartamentit, deklaruar herë në euro dhe herë në lekë.
 2. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjithë veprimet e kryera në vitet 2011 dhe 2012, shumica prej të cilave përbënin veprime juridike të pavlefshme për efekt përfitimit e kredisë së butë. Kjo pamjaftueshmëri ka përfshirë edhe prenotimet e apartamenteve në Durrës dhe Tiranë, dhe shkëmbimin e apartamentit në Tiranë me vëllanë, z. E. M.
 3. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 vlerën prej 4.900.000 lekësh, që mbeti në disponim të tij pas një serie veprimesh kontraktuale që kishin për qëllim mbajtjen e kredisë në llogarinë e tij personale.
 4. Subjekti i rivlerësimit, me veprimet e kryera në funksion të përfitimit të kredisë tregtare në vitin 2007 dhe sidomos me veprimet juridike të kryera në vitet 2011 dhe 2012, për qëllim përfitimi financiar, ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive/të simuluar, të cilat janë në kontradiktë me sjelljen që pritet nga një gjyqtar dhe, si pasojë, ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
48. Lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit *se nuk bazohet në fakte dhe ligj përfundimi i Komisionit lidhur me cilësimin e vëllait, z. E. M., si "person tjetër i lidhur" me subjektin e rivlerësimit*, në analizë të provave dhe ligjit, trupi gjykues vëren se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk bazohet. Trupi gjykues vëren se leximi harmonik i dispozitave që rregullojnë konceptin e *personit tjetër të lidhur* me dispozitat që rregullojnë mënyrën e deklaratimit dhe detyrimet e subjekteve të rivlerësimit në këtë proces, të sjell në përfundimin që marrëdhënia në të cilën një person vendos në hipotekë pronën e tij në emër dhe për përfitim të një subjekti rivlerësimi apo bëhet dorëzanës kundrejt një kreditori, e shndërron të parin në person tjetër të lidhur. Për pasojë, Komisioni ka vlerësuar drejt në cilësimin e z. E. M. *person tjetër i lidhur* me subjektin e rivlerësimit, bazuar në disa rrethana faktike, të cilat janë konstatuar nga Komisioni që në kalimin e barrës së provës subjektit në hetimin administrativ.⁶⁸

48.1. Më konkretisht, në vlerësimin e mësipërm trupi gjykues ka parasysh dispozitat e nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 3, pika 14 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafët 6 e 7 të udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave⁶⁹, respektivisht riprodhuar më poshtë.

⁶⁸Me kalimin e barrës së provës për personin tjetër të lidhur, Komisioni ka referuar faktet që vijnë: i) E. M. zëvendësoi subjektin e rivlerësimit si debitor për kredinë e marrë në Bankën Alpha, duke marrë përsipër pagimin e saj; ii) E. M. zëvendësoi subjektin e rivlerësimit si blerës në apartamentin në rrugën "{***}"; iii) E. M. pagoi shumën për cedimin e kredisë në Bankën Alpha; iv) E. M. i shiti subjektit të rivlerësimit automjetin Audi (në vitin 2014). Në vendim, Komisioni i referohet sa vijon për të mbështetur cilësimin e z. E. M. si person tjetër i lidhur: zëvendëson subjektin e rivlerësimit si debitor për kredinë e marrë në Bankën Alpha, duke marrë përsipër pagimin e saj; zëvendëson subjektin e rivlerësimit si blerës i apartamentit në rr. "{***}" dhe mbas këtij veprimi, në apartamentin ku ai ishte blerësi, ka vijuar banimin subjekti i rivlerësimit, Ervin Metalla; i paguan subjektit të rivlerësimit shumën për cedimin e kredisë në Bankën Alpha; vendos kolateral shtëpinë e tij për kredinë e butë të marrë nga subjekti i rivlerësimit pranë BKT-së. Në shtesën e ankimit, subjekti ankohet se Komisioni e paraqet për herë të parë në vendim vendosjen si kolateral të shtëpisë së vëllait për të garantuar kredinë e butë të BKT-ja, gjë që bie ndesh me dokumentacionin.

⁶⁹“Për mënyrën e deklaratimit të pasurive në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarim të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.8.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSh”.

Neni D

1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. [...] 3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj [...].

Neni 3, pika 14

[...] “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi [...].

Neni 32, pika 4

[...] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...].”

Paragrafi 6

[...] Persona të tjerë të lidhur, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 [...], janë personat fizikë dhe juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit [...]. Kur subjekti i rivlerësimit deklaroi këto lloj marrëdhëniesh juridike me persona të tjerë të lidhur, ai mbart detyrimin të paraqesë dokumentacionin justifikues ligjor, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës, që bëhet objekt i kësaj marrëdhënieje me subjektin e rivlerësimit [...].

Paragrafi 7

[...] Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre [...].

48.2. Në këtë vlerësim, trupi gjykues së pari sjell në vëmendje faktin që z. E. M. rezulton të ketë hyrë në marrëdhënie juridike të vazhdueshme në shërbim dhe për përfitim të njëanshëm, *prima facie*, të subjektit të rivlerësimit, duke marrë përsipër edhe kushte financiare më pak të favorshme apo duke zëvendësuar subjektin sa herë ishte nevoja, në kontrata të ndryshme në harkun kohor 2007-2013, minimalisht. Më konkretisht, përveçse ka zëvendësuar subjektin e rivlerësimit në një kredi për blerjen e një pasurie të paluajtshme, e cila në vazhdimësi është disponuar nga vetë subjekti i rivlerësimit (sikurse pretendon, e nisur në formën e huapërdorjes dhe e vijuar në trajtën e qirasë), z. E. M. është bërë edhe garant në kredinë me kushte lehtësuese me BKT-në – konfirmuar nga kontrata e hipotekimit nr. {***} kol., datë 29.09.2011, sipas së cilës hipotekuesi dhe bashkëshortja e tij [E. dhe Xh. M.] sigurojnë me pasurinë që ndodhet në pronësi të z. E. M.⁷⁰ kredinë, duke përfshirë edhe kamatat,

⁷⁰ Apartament me sipërfaqe 55,8 m² dhe shtesa e ndërtesës me sipërfaqe 10 m², me adresë rr. “{***}”, Tiranë.

shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, si dhe shpenzimet e tjera që ka bërë kredithënësi për të nxjerrë kredinë e tij. Dorëzanësi është i detyruar solidarisht me kredimarrësin (debitorin kryesor) pa kushte dhe në mënyrë të pakthyeshme për ekzekutimin e detyrimit. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se z. E. M. dhe bashkëshortja e tij vazhdojnë të jenë garant në këtë kredi.

48.3. Sipas parashikimeve të neneve 585 e vijues të Kodit Civil, të cilat rregullojnë dorëzaninë, dorëzanësi detyrohet t'i sigurojë kreditorit ekzekutimin e detyrimit të debitorit kryesor. Dorëzanësi përgjigjet për aq sa detyrohet debitori kryesor. Ndërmjet dorëzanësit dhe debitorit ekziston një lidhje interesi që ka për qëllim kryesor shlyerjen e detyrimeve ndaj kreditorit.

48.4. Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren edhe marrëdhënien e qëndrueshme të interesit mes subjektit dhe vëllait të tij, që përfshin huan për blerjen e automjetit në vitin 2004, shlyerjen e pagesës së kredisë në Bankën Alpha, në vlerën 1.000.000 lekë, si dhe përdorimin e apartamentit në rrugën “{***}” nga subjekti përgjatë gjithë kohës kur apartamenti formalisht duhet t'i kishte kaluar z. E. M. (sikurse pretendon subjekti, për të mbuluar pjesën e mbetur nga shuma 17.123,87 euro për cedimin e kredisë në Bankën Alpha).

48.5. Si konkluzion, mbështetur në parashikimet e sipërcituara ligjore dhe në rrethanat faktike të provuara, Komisioni me të drejtë ka vendosur që z. E. M. duhet të përfshihet në rrethin e personave të tjerë të lidhur, siç përcaktojnë neni 3, pika 14 dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

48.6. Nga dokumentacioni në fashikull, rezulton se personi tjetër i lidhur, z. E. M., nuk ka burime të ligjshme financiare për të justifikuar dhënien e shumës prej 1.000.000 lekësh në vitin 2011 dhe vendosjen e pasurisë apartament, të blerë në vitin 2008, si garanci subjektit të rivlerësimit. Pretendimet e subjektit për marrëdhënie të posaçme⁷¹ të vëllait E. M. me biznesin ku ai është i punësuar, nuk u provuan me dokumentacion. Nga dokumentacioni zyrtar në fashikullin e administruar në Komision⁷², rezulton që z. E. M. është i punësuar në njësinë e shërbimit “{***}” dhe prokura e posaçme e lëshuar nga ortakut i vetëm në emër të tij dhe të një individi tjetër, dëshmon vetëm mundësinë e kryerjes së veprimeve që rregullisht shoqërohen me një marrëdhënie mirëbesimi. Nga ana tjetër, trupi gjykues vëren se përkundër pretendimit të subjektit për shkëputje të ortakut të vetëm, z. B. R., për shkak të largësisë gjeografike dhe delegim të drejtimit të biznesit personit tjetër të lidhur, z. E. M., marrëveshjet vjetore të qirasë janë nënshkruar nga vetë pronari dhe qiradhënësi. Duke pasur parasysh sa më sipër dhe faktin që ndërkohë vëllai i subjektit sipas dokumentacionit zyrtar rezulton të ketë marrë pagesa mujore si punonjës, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit mbeti

⁷¹ Në përgjigje të kërkesës për informacion të KPK-së të datës 3.05.2018, subjekti i rivlerësimit është shprehur gjatë hetimit administrativ: “[...] duke filluar nga mesi i vitit 2009, z. B. R. ka vendosur t'i kalojë vëllait, z. E. M., të drejtën e zhvillimit të biznesit/aktivitetit tregtar të regjistruar me të gjitha të drejtat dhe detyrimet përkatëse, duke hequr dorë nga angazhimi në aktivitet, si dhe nga fitimet si ortak [...]”. Sipas subjektit, aktiviteti që nga viti 2009 e në vazhdim është zhvilluar e vazhdon të zhvillohet nga vëllai i tij, z. E. M..

⁷² Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.05.2018, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës, prokurën e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.07.2009; kontratën e qirasë e lidhur më datë 18.05.2015 (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës – nr. {***} prot., datë 18.05.2015), kontratën e qirasë e lidhur më datë 16.05.2014 (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës – nr. {***} prot., datë 16.05.2014), kontratën e qirasë e lidhur më datë 05.04.2013 (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës – nr. {***} prot., datë 05.04.2013), kontrata e qirasë e lidhur më datë 16.05.2012 (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës – nr. {***} prot., datë 16.05.2012), kontratën e qirasë e lidhur më datë 16.05.2011 (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës – nr. {***} prot., datë 16.05.2011); kontratën e qirasë e lidhur më datë 10.09.2007 (Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Durrës – nr. {***} prot., datë 10.09.2007).

deklarativ dhe fitimet e pretenduara nga biznesi në fjalë si pronar dhe jo punonjës, mbetën të paprovuara.

48.7. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka marrë përgjigje për kërkesën për revokim të vendimit të ndërmjetëm të Komisionit për konsiderimin e vëllait person tjetër i lidhur, nuk qëndron. Nga rezultatet e hetimit administrativ rezulton se Komisioni e ka konsideruar vëllanë e subjektit *person tjetër të lidhur* duke i kaluar edhe barrën e provës në funksion të dispozitës së nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016⁷³. Përkundër pretendimit të subjektit të rivlerësimit se ILDKPKI-ja në asnjë rast nuk e ka cilësuar vëllanë e subjektit person tjetër të lidhur, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se institucionet e rivlerësimit kryejnë hetim të pavarur⁷⁴. Ky qëndrim përputhet edhe me vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese që shprehet mbi lejimin e institucioneve të rivlerësimit për të hetuar në mënyrë të pavarur për të gjitha rrethanat e çështjes, duke kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe se në këtë proces ato nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse, sikurse edhe rezultatet e ILDKPKI-së, çka i jep tagrin Komisionit apo Kolegjit të hetojë dhe vlerësojë vetë rrethanat e çështjes.

48.8. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit që barra e provës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së vëllait ka qenë e shpërpjesëtuar dhe e pakufizuar, qëndron. Nga hetimi administrativ dhe vendimi i Komisionit, rezulton se subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës për të dorëzuar dokumentacion provues për burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait për një periudhë relativisht të gjatë, vitet 2008-2016, dhe për gjithë pasurinë e këtij të fundit. Një qasje proporcionale e pasurisë objekt interesi do të ishte në përputhje me parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit në shqyrtimin dhe kalimin e barrës së provës në procesin e rivlerësimit⁷⁵, të materializuar edhe në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit⁷⁶ dhe në mungesë të indicieve të besueshme për fshehje pasurie të subjekteve të rivlerësimit. Në rastin konkret, barra e provës proporcionale do të duhet të përfshinte pasurinë objekt interesi pasuror – në këtë rast apartamentin në pronësi të z. E. M., likuiditetet në vlerën 1 milion lekë dhe huan në vlerën 1.700 euro për blerjen e automjetit në vitin 2004.

II) Shkaqet e ankimit që lidhen me procesin dhe zhvillimin e procedurës

49. Subjekti i rivlerësimit pretendon për shkelje të të drejtave të tij për një proces të rregullt, meqenëse procesi i rivlerësimit është kryer bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, shoqëruar me kërkesën për hetim nga Kolegji edhe për dy kriteret e tjera (kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale). Në analizë të dispozitave ligjore të zbatueshme dhe dokumentacionit në fashikull e pretendimit të subjektit, trupi gjykues arrin në përfundimin se ky pretendim nuk qëndron.

49.1. Nenet D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës qartësisht zbërthejnë procesin e rivlerësimit në kriteret e cilat edhe veçmas mund të sjellin pasojë shkarkimin e subjekteve të rivlerësimit. Më tej, në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, ligjvënësi ka çmuar se është në interesin

⁷³ Referuar kërkesës për informacion mbi burimin e të ardhurave të vëllait E. M. (shoqëruar me dokumentacion provues), përcjellë në rrugë elektronike më datë 03.05.2018.

⁷⁴ Neni 45, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “[...] 1. Anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit [...]”.

⁷⁵ Neni 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit në shqyrtimin e çështjes udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit [...]”.

⁷⁶ Shih vendimin nr. 15, datë 17.07.2019 në: <http://kpa.al/web-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-Dritan-Rreshka-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>.

publik shqyrtimi i çështjes brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm dhe, për këtë arsye, ka ligjëruar përfundimin bazuar vetëm në një kriter, kur rezultatet e hetimit për kriterin përkatës janë të mjaftueshme për të mbështetur vendimmarrjen. Më konkretisht, neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon:

[...] 2. Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave [...].

49.2. Në referim të nenit 179/b, pika 1 e Kushtetutës, që parashikon se: “Sistemi i rivlerësimit ngrihet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, si edhe të rikthehet besimi i publikut tek institucionet e këtij sistemi”, interpretuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁷⁷, rezulton që procesi i rivlerësimit nuk ka për qëllim të verifikojë detyrimisht të tria kriteret e vlerësimit për subjektet e rivlerësimit, si një proces që përcakton standardin e tyre në përmbushje të detyrës apo gradën e vlerësimit të tyre. Kushtetuta dhe ligji kërkojnë që ky proces të zhvillohet në funksion të rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë dhe të garantimit të funksionimit të shtetit të së drejtës. Në këtë kontekst të qëllimit të Kushtetutës, nuk do të kishte asnjë vlerë dhe qëllim të ligjshëm vazhdimi i procedurës për rivlerësimin e kriterëve të tjera, për sa kohë arrihet në konkluzionin se në verifikim edhe të një kriteri, një subjekt rivlerësimi do të duhet të largohet nga sistemi i drejtësisë me qëllim rikthimin e besimit të publikut te drejtësia.

49.3. Nga ana tjetër, neni 59 i ligjit nr. 84/2016, në pikën 1 parashikon se për konfirmimin në detyrë duhet që subjekti të rezultojë se përmbush të tria kriteret dhe, si i tillë, arrin të ketë në mënyrë kumulative nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Fakti që neni 59 i ligjit nr. 84/2016, me qëllim konfirmimin në detyrë, kërkon domosdoshmërisht vlerësimin pozitiv të të tria kriterëve së bashku, nuk ndalon Komisionin që në rastet kur rezulton se nga hetimet e kryera, për një apo dy kriteret një subjekt nuk arrin një nivel të besueshëm, të mund të përfundojë rivlerësimin duke e bazuar edhe në një kriter. Ky qëndrim vjen edhe në funksion të moszgjatjes së procesit të rivlerësimit me hetime dhe rivlerësime për kriteret që edhe nëse rezultojnë me nivel kualifikues (referuar dy kriterëve të tjera), nuk ndryshojnë rezultatit mbi procesin e rivlerësimit të subjektit. Në vendimin për subjektin e rivlerësimit, Komisioni ka nënvizuar se marrja e vendimit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit vetëm mbi kriterin e kontrollit të pasurisë, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të figurës dhe atë profesional.

- 50.** Subjekti i rivlerësimit parashtron se arsyetimi i Komisionit është i pjesshëm, pjesërisht kontradiktor dhe pjesërisht në kundërshtim me qëndrimet e vetë Komisionit në çështje të ngjashme. Në analizë të ligjit dhe dokumentacionit në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit pretendon për parregullsi në procesin e zhvilluar nga Komisioni për faktin se vendimi, sa i takon deklarinimit të papranueshëm të shpjegimeve dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 467, germa “e” e K.Pr.Civile, në vlerësimin e subjektit është kontradiktor për sa i përket shkakut të përfitimit të kredisë së butë, interpretimit të kontratave dhe të marrëdhënies juridike me vëllanë dhe se vjen në kundërshtim me qëndrimet e vetë Komisionit në raste të ngjashme. Këtë qëndrim subjekti i rivlerësimit e ka shprehur gjerësisht edhe në shtesën e ankimit, duke parashtruar raste të ngjashme, por të gjykuara ndryshe nga rasti i tij prej Komisionit.

⁷⁷ Shih vendimin nr. 6/2018(JR) - http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendim-Perfundimtar_B-N_i-anonimizuar-pdf.pdf, nr. 1/2019(JR) - <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/12/Vendimi-A-Licaj-i-anonimizuar-pdf>, nr. 15/2019 (JR) - <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/10/Vendimi-SR-Dritan-Rreshka-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>, nr. 23/2019 etj.

50.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNj-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe iu jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë.⁷⁸ Në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin ligjor, duke mbajtur qëndrimin se:

Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (shih vendimin nr. 18, datë 15.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

50.2. Në përputhje edhe me këtë shtjellim të parimeve të shtetit të së drejtës dhe transparencës së gjyqësorit nga Gjykata Kushtetuese, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se Komisioni është shprehur bazuar në faktet dhe provat që janë paraqitur gjatë procesit dhe që janë administruar në gjykim, duke pasqyruar mënyrën e vlerësimit dhe të interpretimit të provave prej tij, si dhe duke arsyetuar dhe argumentuar secilën prej çështjeve që kanë çuar në qëndrimin e mbajtur në dispozitiv. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron. Trupi gjykues çmon edhe të theksojë po ashtu se parashikimet e nenit 467, germa "e" e K.Pr.Civile⁷⁹ nuk zbatohen në këtë proces. Në zbatim të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, është vetë arsyetimi i Kolegjit⁸⁰ që përmbush detyrat e këtij të fundit për orientimin e vendimmarrjes së Komisionit. Rikthimi për rishqyrtim Komisionit nga Kolegji është shprehimisht i ndaluar nga Neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës⁸¹.

51. Lidhur me shkakun e ankimit të subjektit të rivlerësimit *se i është kërkuar në kundërshtim me ligjin të provojë ligjshmërinë e burimeve të krijimit të të gjitha pasurive në pronësi të vëllait përgjatë tërë jetës pa pasur asnjë lidhje me to, duke i ngarkuar një barrë të shpërpjesëtuar prove*, trupi gjykues i Kolegjit vëren se sikurse është analizuar edhe në paragrafin 48 të këtij vendimi, vëllai i subjektit të rivlerësimit duhet të konsiderohet person tjetër i lidhur në kuptim të dispozitave të posaçme ligjore të parashikuara nga ligji nr. 84/2016. Nga ana tjetër, kërkimi nga ana e Komisionit të dokumentacionit provues për burimin e ligjshëm të të gjitha ardhurave për periudhën 2008-2016, siç shtjellohet në nënparagrafin 48.8, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, e ka vendosur subjektin e rivlerësimit në kushte të një barre prove të shpërpjesëtuar dhe bie ndesh me parimet e barrës së provës në procesin e rivlerësimit dhe me jurisprudencën e Kolegjit.

⁷⁸ Shih vendimin nr. 18, datë 15.03.2016, vendimin nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese.

⁷⁹ Neni 467, germa "e" përcakton: "Gjykata e apelit prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht, sipas kufijve të nenit 121, të këtij Kodi, dhe e dërgon çështjen për rigjykim kur: e) gjykata e shkallës së parë nuk e ka kryer shqyrtimin gjyqësor të të gjitha kërkimeve lidhur me objektin e mosmarrëveshjeve."

⁸⁰ Neni 66, pika 2 përcakton: "[...] Kolegji i Apelit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme [...]"

⁸¹ "[...] Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim [...]"

52. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim se pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 kërkon njëkohësisht, veç deklarimit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, edhe deklarim të pamjaftueshëm sa i takon kriterit të kontrollit të figurës, hetimi administrativ për të cilin nuk ka përfunduar prej Komisionit, trupi gjykues vëren se në përfundim të hetimit, Komisioni ka vendosur bazuar në kriterin e kontrollit të pasurisë në referim të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, e për pasojë, masa disiplinore e shkarkimit nga detyra rrjedh pikërisht nga këto parashikime ligjore. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 interpretohet në mënyrë kumulative, nuk qëndron. Vlerësimi i përcaktuar nga kjo dispozitë është alternativ dhe u përket dy kritereve të ndryshme, të zbërthyer në dispozita të ndryshme dhe që përmbajnë dy kritere rivlerësimi. Në rastin konkret, subjekti është shkarkuar vetëm për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë. Trupi gjykues i Kolegjit nënvizon se tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar me anë të së cilës Kolegji ka interpretuar dispozitat e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 në mënyrë shteruese, që konkludojnë se është e panevojshme që pamjaftueshmëritë në deklarimin për kontrollin e pasurisë dhe të figurës të ekzistojnë në mënyrë kumulative për të konkluduar me vendimmarrjen për shkarkim nga detyra.⁸²
53. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit pasi analizoi të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni dhe shqyrtoi vendimin nr. 45, datë 23.07.2018, të Komisionit mbi bazën e shkaqeve të ankimit, mbështetur në konkluzionet e mësipërme, konstatoi se:
1. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë apartament banimi, me sipërfaqe 96,8 m² dhe garazh, me sipërfaqe 22,5 m², me adresë rruga “{***}”, Tiranë, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, sipas nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.
 2. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose pasqyruar në mënyrë të pasaktë pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 96,8 m² dhe garazh, me sipërfaqe 22,5 m², me adresë rruga “{***}”, Tiranë, në kushtet kur ka poseduar dhe përdorur në mënyrë të pandërprerë këtë pasuri të ndodhur jashtë qytetit në të cilin ushtronte veprimtarinë e gjyqtarit/kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa kishte përfutur kredi me kushte lehtësuese për shkak të detyrës në qytetin ku kryente detyrën, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose përdorim të tij, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
 3. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë veprime që përbëjnë pasaktësi në deklarime për sa u përket likuiditeteve bankare në pronësi të tij në vitin 2011, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, me të

⁸² Shih: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/09/Vendim-Trezhnjeva-p%C3%ABr-web.pdf>; <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/10/Vendimi-i-plot%C3%AB-Mendimi-paralel-Mendimi-i-pakic%C3%ABs.pdf>; <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/11/Vendimi-nr.-9-20182canonimizuar-A.-Xh..pdf>; <http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/02/Vendimi-i-anonimizuar-subjekti-B.-Dedja.pdf>; <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.-I-date-31.01.2019-subjekti-Artan-Lazaj-vendimi-mendimi-i-pakic%C3%ABs-per-publikim.pdf>; <http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-A.-Sevdari-i-anonimizuar-per-publikim.pdf>; http://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi_E-S-_5_-06_2019_I_ANONIMIZUAR.pdf; http://kpa.al/wp-content/uploads/2019/06/Vendimi_08_16.04.2019_SR_-Arben_Nela.pdf etj.

drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

4. Subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave të “personit tjetër të lidhur”, vëllait E. M., sipas përcaktimeve të neneve 3, pika 14 dhe 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me pasurinë e lënë në garanci dhe likuiditetet që kanë shërbyer për të shlyer detyrimet e lidhura me cedimin e kredisë tregtare në Bankën Alpha. Për këtë arsye, me të drejtë Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të vëllait të tij, sipas parashikimeve të nenit D, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës.
54. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit me veprimet e kryera në funksion të përfitimit të kredisë tregtare në vitin 2007 dhe sidomos me veprimet juridike të kryera në vitet 2011 dhe 2012, për qëllim përfitimi financiar, ka kryer një sërë veprimesh juridike fiktive/të simuluar, të cilat nuk përputhen me sjelljen etike që një gjyqtar pritet të ketë dhe ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
55. Mbështetur në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe vendimi i Komisionit është i drejtë e duhet lënë në fuqi.
56. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pasi e gjykoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016 dhe në nenet 49 e 55 të ligjit nr. 49/2012, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ervin Metalla gjendet në kushtet e nenit D, pikat 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 45, datë 23.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.10.2019.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi - kundër

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi - kundër

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne, gjyqtaret Albana Shtylla dhe Ina Rama, kemi votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues në çështjen që i përket ankimit të subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla, kundër vendimit nr. 45 datë 23.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), nëpërmjet të cilit është vendosur lënia në fuqi e vendimit të mësipërm të Komisionit dhe është konfirmuar shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla. Vota kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues është shoqëruar edhe me qëndrimin tonë për zgjidhjen e çështjes, i cili është i mbështetur në parashikimin e nenit 66, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016) dhe konsiston në prishjen e vendimit nr. 45, datë 23.07.2018, të Komisionit dhe urdhërimin e Komisionit që të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit edhe me verifikimin e dy kriterëve të tjera, të parashikuara nga ligji nr. 84/2016, atë të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe që të konkludojë për procesin e rivlerësimit ndaj subjektit në varësi të konkluzioneve që do të ketë nga hetimi i mëtejshëm administrativ.
2. Në mënyrë të përmbledhur⁸³, Komisioni ka mbështetur vendimin e tij të shkarkimit mbi dy elemente, të cilat i ka konsideruar të lidhura me kriterin e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit:
 - i) veprimet juridike të kryera prej tij për të përfituar një kredi lehtësuese për financimin e banesës në pronësi të tij, të cilat janë konsideruar se kanë qenë fiktive dhe vetëm në funksion të qëllimit për të përfituar në mënyrë të paligjshme kredinë me kushte lehtësuese, duke realizuar në këtë mënyrë një sjellje që vjen në kundërshtim me rregullat etike të detyrueshme për t’u respektuar nga një gjyqtar, si dhe
 - ii) pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të justifikuar të gjitha pasuritë e vëllait të tij, z. E. M., i konsideruar prej Komisionit si person tjetër i lidhur i subjektit.Këto shkelje janë konsideruar prej Komisionit se kanë çuar subjektin në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
3. Në vlerësimin tonë, ankimi i subjektit të rivlerësimit dhe shkaqet e parashtruara prej tij, në tërësinë e tyre qëndrojnë dhe e bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit për shkarkimin e tij, pasi në thelb arsyet e përdorura nga Komisioni dhe të konfirmuara edhe nga qëndrimi i mbajtur nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, nuk përbëjnë shkaqe apo shkelje të konsideruara nga ligji, të cilat mund të passjellin vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit.

I. Mbi veprimet juridike të kryera për të përfituar një kredi lehtësuese

4. Sipas këtij vlerësimi, veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet të cilave ai ka synuar të fitojë pronësinë mbi apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, dhe financimin e blerjes së kësaj pasurie, fillimisht me anë të një kredie tregtare të përfituar nga Banka Alpha dhe më pas me anë të përfitimit të kredisë me kushte lehtësuese të përfituar nga Banka Kombëtare Tregtare (në vijim “BKT”), të përshkruara në mënyrë të detajuar në arsyetimin e shumicës së trupit gjykues të Kolegjit, nuk duhet të konsiderohen se janë kontrata fiktive dhe se nuk janë kryer në kundërshtim me përcaktimet e urdhërimit ligjorë në fuqi. Për më tepër, kemi një vlerësim të ndryshëm për sa u përket konkluzioneve të shpallura

⁸³ Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ e të pranuar si të vërteta edhe nga Kolegji në vendimin e shumicës, janë të pranuar edhe nga gjyqtarët në pakicë dhe, për këtë arsye, ato nuk konsiderohen të nevojshme të citohen në mënyrë kronologjike në këtë mendim, përveçse të referohen çdo herë që nevojitet për të mbështetur arsyetimin.

prej Komisionit dhe shumicës në Kolegj, se shkeljet e kryera në këndvështrim të këtyre veprimeve juridike duhet të konsiderohen se janë pasaktësi të deklarime periodike, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a”, dhe si të tilla përbëjnë shkak për deklarim të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Vlerësimi ynë mbi faktet e konstatuara prej hetimit administrativ në një këndvështrim të ndryshëm të tyre gjatë shqyrtimit të shkaqeve të ankimit, na ka çuar në disa konkluzione të cilat mund të përmbliken si më poshtë.

5. Kontrata paraprake e shitjes e lidhur mes subjektit të rivlerësimit Ervin Metalla dhe shtetasit E. H., me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.07.2007, për shitjen e apartamentit nr. {***} dhe të garazhit të ndodhur në Tiranë, në rrugën “{***}”, pall. {***}, e cila ka shërbyer për të legjitimuar përfitimin e kredisë tregtare prej Bankës Alpha, kredi e finalizuar me nënshkrimin para noterës publike Dh. Q. të aktit “Kontratë për kufi kredie shumëqëllimore”⁸⁴ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 26.07.2007, nuk është një kontratë fiktive në kuptim të parashikimit për fiktivitetin, sipas nenit 92, germa “ç” e Kodit Civil, ku parashikohet se:
Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar).
6. Kontrata paraprake e shitjes e cituar më lart, rezulton se ka prodhuar në fund pasojat e saj ligjore, të cilat janë ato të dëshiruara e të deklaruara në përmbajtjen e saj për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi objektin e shitjes nga shitësi të blerësi. Këto pasoja janë krijuar që në momentin e nënshkrimit të saj dhe vazhdojnë të jenë në fuqi edhe sot. Ndryshimi i çmimit të kësaj kontrate sipas parashikimit të vetë palëve të saj, nuk mund të jetë një shkak që sjell pavlefshmërinë e kontratës, por vetëm një objekt debati e kundërshtish në një konflikt të mundshëm civil mes palëve të një kontrate në kushtet e ndryshimit të saj, rrethanë e cila nuk rezulton të ketë ndodhur në rastin konkret. Çmimi mbetet sigurisht një nga kushtet themelore të një kontrate shitjeje, por ndryshimi i tij nuk passjell pavlefshmërinë e kontratës, aq më tepër fiktivitetin e saj.
7. Aneksi i kontratës, i lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shitësit E. H. e vëllait të subjektit, z. E. M., datë 22.03.2011, i cili ka parashikuar kalimin e së drejtës së subjektit të rivlerësimit për të përfituar të drejtën e pronësisë mbi shtëpinë kundrejt shitësit E. H. si pasojë e cedimit të kredisë që subjekti kishte marrë nga Banka Alpha të vëllai i tij, nuk është një kontratë fiktive në kuptim të parashikimeve të mësipërme ligjore. Kjo kontratë i ka paraprirë marrëveshjes së subjektit me Bankën Alpha dhe vëllain tij E. M., realizuar me kontratën me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.2011, nëpërmjet së cilës kredia e disbursuar në favor të subjektit i cedohej vëllait të tij, i cili duke zëvendësuar subjektin në këtë pozicion, morri përsipër detyrimet e kredimarrësit ndaj bankës, si edhe të drejtën për të fituar pronësinë e apartamentit objekt i aneksit të kontratës së cituar. Nga hetimi ka rezultuar se vëllai i subjektit ka vazhduar që prej kohës së nënshkrimit të kontratës të qëndrojë në pozitë e kredimarrësit ndaj Bankës Alpha dhe të paguajë detyrimet ndaj saj. Gjithashtu ka rezultuar se në vitin 2012 ai ka shkëmbyer me paditësin të drejtat e tij për të fituar pronësinë mbi këtë apartament kundrejt të drejtave ndaj një pasurie tjetër të porositur e të shlyer prej subjektit, sipas nënshkrimit të aktmarrëveshjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2013, lidhur mes tyre e me pëlqimin e shoqërisë “{***}” ShPK.
Duke konsideruar këto rrethana, vlerësojmë se as ky veprim juridik nuk është një veprim i pavlefshëm, për shkak të parashikimit të nenit 92, germa “ç” e Kodit Civil, për sa kohë ai ka prodhuar pasojat e dëshiruara prej palëve e të deklaruara në përmbajtjen e tij.

⁸⁴ E regjistruar në Bankën Alpha me nr. {***}, datë 25.07.2007.

8. Kemi vlerësuar se kontrata e lidhur me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 30.06.2011, mes subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e porositësit, dhe shoqërisë “{***}” ShPK për prenotimin e një apartamenti, me sipërfaqe 81,8 m² në Durrës, nuk është gjithashtu një kontratë fiktive. Në mbështetje të kësaj kontrate, me të cilën ishte porositur ndërtimi i një apartamenti në qytetin e Durrësit, aty ku subjekti ushtronte detyrën e gjyqtarit, subjekti ka përfituar kredinë lehtësuese nga BKT-ja në shumën prej 5.000.000 lekë, me të cilën ka financuar porositjen e kësaj pasurie. Subjekti dhe shoqëria kanë rënë dakord të zgjidhin kontratën e mësipërme për shkak se subjekti ka synuar blerjen e apartamentit në qytetin e Tiranës, si një zgjidhje më të përshtatshme për të. Palët në këtë marrëveshje, duke reflektuar vullnetet e tyre, janë dakordësuar duke kaluar nëpër fazat përkatëse të konkludimit të marrëveshjes, të zgjidhin kontratën e porosisë, duke i kthyer njëra-tjetrës çdo të drejtë që kishte lindur prej kontratës së porosisë. Subjekti ka hequr dorë nga pritshmëria për ndërtimin e apartamentit në Durrës dhe shoqëria ka kthyer tek ai pagesat e kryera prej tij nëpërmjet kredisë prej 5.000.000 lekësh dhe shumës prej 2.500.000 lekësh, pagesa të cilat përbënin çmimin total të porosisë.
9. Në këto kushte, pasojat ligjore të krijuara prej kësaj marrëveshjeje, kanë përfunduar për shkak të zgjidhjes së kësaj kontrate përfundimisht me deklaratën noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2012, dhe shoqëria “{***}” ShPK i ka kthyer subjektit të rivlerësimit vlerën 2.500.000 lekë, referuar mandatarkëtimit të administruar nga Komisioni, ndërsa shuma prej 5.000.000 lekësh ishte kthyer sipas transaksionit bankar të kryer pranë BKT-së, në datën 27.10.2011, nga “{***}” ShPK te babai i subjektit të rivlerësimit, z. N. M.
10. Bazuar në nenin 690 të Kodit Civil, i cili parashikon se: *Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj*, palët kanë shprehur vullnetin për ta zgjidhur kontratën me marrëveshje mes tyre, duke i anuluar të gjitha pasojat ligjore të krijuara prej saj.
11. Në vijim të veprimeve juridike në të cilat subjekti ka ndërvepruar si palë, rezulton edhe marrëveshja e datës 20.04.2012 e lidhur mes subjektit të rivlerësimit në cilësinë e njërit prej ceduesve, me huadhënës B. G. dhe huamarrës B. K. dhe ceduesit tjetër N. M., sipas përcaktimeve të së cilës subjekti ka harmonizuar vullnetin e tij për të porositur një apartament te shoqëria “{***}” ShPK, aksioner i të cilës është shtetasi B. K., me vullnetin e palëve të tjera pjesëmarrëse për të shlyer nëpërmjet kompensimeve reciproke detyrimet e ndërsjella. Në thelb të kësaj marrëveshjeje, në raport me subjektin, shtetasi B. K., në emër shoqërisë “{***}” ShPK, konsideron të shlyer detyrimin e subjektit për të paguar shumën prej 5.000.000 lekësh, si pjesë e çmimit të porositjes së një apartamenti në Tiranë, në kompensim të detyrimeve të këtij të fundit me shtetasin B. G., dhe shlyerjes së detyrimit që ky i fundit kishte ndaj babait të subjektit të rivlerësimit, z. N. M.
12. Kjo marrëveshje ka krijuar premisat për lidhjen e kontratës paraprake të porosisë mes subjektit e shoqërisë “{***}” ShPK, në datën 23.04.2012, për porositjen e një apartamenti në Tiranë që do të ndërtohet nga kjo shoqëri. Si financim për blerjen e kësaj pasurie, shërben shuma prej 5.000.000 lekësh, e konsideruar e shlyer shoqërisë, në zbatim të aktmarrëveshjes së cituar më lart, si edhe mandatarkëtimit nr. {***}, datë 23.04.2012, si edhe diferenca prej 2.500.000 lekësh, e cila do të paguhej prej subjektit brenda vitit 2012. Në datën 31.12.2012, subjekti nënshkruan me këtë shoqëri kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., për porositjen e një apartamenti me çmim 7.500.000 lekë, të ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë.
Pavarësisht kompleksitetit të realizimit të këtyre veprimeve juridike të sipërcituara mes palëve e vështirësisë për të kuptuar mekanizmin e tyre, në vlerësimin e pakicës, nuk konstatohen në këto veprime elemente që mund të shkaktojnë pavlefshmëri apo kundërshti me urdhërimet e parashikuara në ligj. Fakti që shoqëria “{***}” ShPK rezulton të ketë qenë

me status “pasiv”, sipas të dhënave të pasqyruara në regjistrat e QKB-së, nuk cenon në vlerësimin tonë, vlefshmërinë apo kredibilitetin e marrëveshjes së nënshkruar mes subjektit dhe kësaj shoqërie, duke qenë se nuk rezulton ndonjë detyrim i palëve kontraktore për të verifikuar statusin e tyre reciprok, për sa kohë që nuk rezultojnë të dhëna që vënë në dyshim këtë gjendje apo edhe vetë mundësinë e palëve për të shlyer detyrimet e marra përsipër. Në këtë kuptim, kjo rrethanë nuk mund të konsiderohet se ka afektuar vetë pasojat ligjore që do të prodhonte kjo marrëveshje, për më tepër, që edhe nga rrethanat e çështjes, nuk figuron që kjo rrethanë të ketë sjellë ndonjë pasojë të natyrës praktike e ligjore, lidhur me ekzekutimin e kontratës së porosisë.

13. Në konkluzion të këtyre veprimeve juridike, subjekti ka nënshkruar marrëveshjen e këmbimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2013, mes tij dhe vëllait të tij E. M., me pëlqimin e shoqërisë “{***}” ShPK, duke këmbyer përfundimisht apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë, i cili kalon në pronësi të subjektit, me apartamentin në rrugën “{***}” po në Tiranë, i cili do të kalojë në pronësi të vëllait të subjektit, pas regjistrimit të tij në ZRVPP.
14. Në përmbledhje të këtyre konkluzioneve, pakica vlerëson të nënvizojë qëndrimin se analiza e veprimeve ligjore të përshkruara më lart, vlen të kryhet në këtë proces jo për të konkluduar dhe marrë qëndrime apo vendime të natyrës së gjykimeve civile, kompetencë e cila del jashtë juridiksionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për shkak të juridiksionit tërësisht disiplinor që kjo gjykatë ka në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, por për të analizuar nëse në thelb të këtyre veprimeve me natyrë civile gjenden elemente që tregojnë për përpjekje për të kamufluar veprime të subjektit të rivlerësimit që vijnë ndesh me urdhërimet ligjore në fuqi e të cilat përfaqësojnë përpjekje për të justifikuar pasuri të fituara me burime të paligjshme apo për të justifikuar mungesën e burimeve të ligjshme, si edhe për të mbuluar deformimet në deklaratimet e bëra në deklaratën *vetting*, qofshin ato fshehje të pasurive apo deklarime të rreme.
15. Në rastin objekt gjykimi, vlerësojmë në analizë të të gjitha fakteve dhe konkluzioneve të pasqyruara më lart, se subjekti i rivlerësimit Ervin Metalla është përfshirë në një sërë veprimesh juridike që kanë ndjekur dhe afektuar njeri-tjetrin, duke krijuar të drejta e marrë përsipër detyrime, në funksion të një qëllimi që është konsideruar se meriton kontrollin e verifikimin e ligjshmërisë së tij në kuptim të këtij procesi, i cili është financimi i blerjes së një apartamenti banimi, në të cilin ai banon, nëpërmjet përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese, e subvencionuar nga organet shtetërore për një kategori funksionarësh publikë, në të cilët bëjnë pjesë edhe gjyqtarët.
Në këtë kontekst, verifikimi i këtij qëllimi, nëse ai është në përputhje me vetë qëllimin e normave ligjore që parashikojnë përfitimin e këtyre kredive në harmoni me aktivitetin juridiko-civil në të cilin është përfshirë subjekti, është një proces i cili merr kuptim dhe duhet të jetë pjesë e verifikimeve që kryhen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në zbatim të detyrimit kushtetues që ka subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës për të provuar burimin e ligjshëm të pasurive të tij.
Për t’i dhënë zgjidhje kësaj çështjeje, pakica çmon të evidentojë dhe të analizojë rrethanat faktike dhe rregullimet ligjore të mëposhtme.
16. Një element i rëndësishëm në të cilin mbështetet me të drejtë edhe mbrojtja e subjektit të rivlerësimit, është fakti se subjekti i rivlerësimit, siç ka rezultuar gjatë hetimit administrativ në Komision, ka në pronësinë e tij vetëm një banesë, të ndodhur në rrugën “{***}” në Tiranë, e cila është banesa e financuar prej kredisë lehtësuese që ai ka përftuar nga BKT-ja, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 12.09.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve publikë”, i ndryshuar (në vijim “VKM-ja nr. 600, datë 12.09.2007”). Qëllimi i miratimit të këtij akti ka

qenë mbështetja dhe ndihma financiare që synohej t'u jepej nëpunësve dhe funksionareve të lartë publikë për të financuar blerjen e banesave në të cilat ata do të jetonin në territorin ku ushtronin funksionet e tyre. Përfitimi nga kjo e drejtë, sipas VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007, kushtëzohej me plotësimin e disa kushteve, në thelb të të cilave qëndron mospasja në pronësi prej nëpunësit/funksionarit publik dhe bashkëshortit/es të një banese tjetër, apo të një sipërfaqeje banimi të standardizuar si të përshtatshme, apo të likuiditeteve me vlerë më të madhe se vlera e shumëzimit maksimale për kreditim, si dhe mospasja e aktiviteteve tregtare në territorin e vendit ku ata ushtrojnë funksionet.

17. Në kuptim të këtyre kushteve, në vijim edhe të analizës dhe konkluzioneve të mësipërme, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur në pronësi në momentin e plotësimit të deklaratës në funksion të kësaj procedure, pasuri të tjera të cilat do ta vendosnin atë në kundërshtim me kushtet që parashikon VKM-ja nr. 600, datë 12.09.2007. Ai këto të drejta pasurore nuk i ka pasur as në vendin ku ushtronte detyrën në qytetin e Durrësit, por as në qytetin e Tiranës, për shkak se kishte hequr dorë nga marrëveshja e nënshkruar për blerjen e shtëpisë në rrugën “{***}” në Tiranë, ndërkohë që vetë VKM-ja kërkonte si kusht mospasjen e kësaj pasurie vetëm në qytetin e Durrësit. Qëllimi i këtij akti ka qenë të mbështesë funksionarët publikë në vendet ku ata ushtrojnë funksionet të cilat mund të jenë larg vendeve ku ata kanë banuar e mund të kenë pronësinë mbi banesa të tjera, por që kjo rrethanë nuk përbën një kusht përjashtues sipas VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007. Në këtë kuptim, subjekti konstatohet se nuk ka pasur pasuri të tilla as në vendin ku ushtronte funksionin dhe as në vendin ku banonte.
18. Për të kuptuar më qartë qëllimin e VKM-së nr. 600, datë 12.09.2007 dhe gamën e përfituesve prej saj, pakica e sheh me vend të analizojë rregullimet e udhëzimit të përbashkët të ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe ministrit të Financave nr. 6257, datë 2.9.2008, “Mbi përcaktimin e masës së subvencionit për familjet që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti”. Sipas pikës 22 të këtij udhëzimi, parashikohet e drejta e subjekteve përfituese të kredisë me kushte lehtësuese për të transferuar kreditë e marra për strehim përpara fillimit të programit të trajtimit me kredi lehtësuese, me kredinë lehtësuese. Në terma praktikë, ky rregullim lejonte dhe mundësonte që subjektet përfituese mund të aplikonin për të fituar kredi me kushte lehtësuese edhe në kushtet e pasjes së një kredie tregtare që kishte financuar blerjen e banesës që siguronte strehimin për ta. Në këtë kontekst, qëllimi i deklaruar prej subjektit se ai ishte përpjekur të financonte me një kredi lehtësuese blerjen e banesës së tij, për të cilën ai kishte aplikuar fillimisht për një kredi tregtare, e cila edhe ishte akorduar, vjen në përputhje edhe me qëllimin e vetë udhëzimit të mësipërm. Kjo rrethanë, në këndvështrimin e pakicës së trupit gjykues të Kolegjit, e bën të ligjshëm qëllimin e subjektit, i cili e ka orientuar atë drejt kryerjes së një sërë veprimesh juridike për ta realizuar. Ajo që duket se subjekti ka synuar, të ndihmojë ekonominë e tij familjare për të financuar me kushte lehtësuese blerjen e banesës së tij të vetme, duket se vjen në përputhje me vetë qëllimin e autoriteteve shtetërore për miratimin dhe implementimin e këtij programi lehtësues. Ajo që duket se prevalon në këtë analizë, është mungesa e qëllimit për të shtuar pasuri apo për t'i siguruar vetes e familjes banesa lüks apo banesa jo të domosdoshme për strehim në kurriz të taksapaguesve e duke shfrytëzuar funksionin.
19. Në këtë logjikë, vlerësojmë se edhe blerja e banesës përfundimisht në Tiranë dhe jo në qytetin e Durrësit në të cilin subjekti ushtronte aktivitetin, qytet në të cilin ai ushtroi aktivitetin më pas, nuk cenon dhe nuk bie në kundërshtim me qëllimin e vetë akteve nënligjore që rregullojnë përfitimin nga kredia me kushte lehtësuese. Qëllimi i autoriteteve shtetërore ka qenë të suportojnë strehimin e funksionarëve publikë në vende ku ata e kanë të mundur të ushtrojnë në mënyrë sa më efektive funksionet e tyre, duke i mbështetur ata, por

edhe duke lehtësuar jetesën e tyre, për t'u dhënë mundësinë e ushtrimit të funksionit në mënyrë dinjitoze. Zgjedhja e Tiranës për blerjen e banesës përkundrejt qytetit të Durrësit, konsideruar distancën e shkurtër dhe faktin që shumë funksionarë publikë dhe jo vetëm, e përshkojnë këtë rrugë çdo ditë për të plotësuar detyrimet e tyre të punësimit apo nevoja të ndryshme, brenda një konteksti normaliteti, është tashmë një realitet që nuk mund të mohohet dhe që konservon në këtë optikë qëllimin për suport e mbështetje të funksionarëve, për më tepër kur cedimi nga komoditeti që të jep banesa në vendin ku ushtron funksionin është një zgjedhje e vetë funksionarit. Në vlerësimin e pakicës së trupit gjykues të Kolegjit, kjo sjellje do të kishte një peshë e ndikim të ndryshëm në gjykim nëse subjekti do të kishte abuzuar për të përfituar prej kësaj kredie të butë për të shtuar pasuritë e tij apo për aktivitete që dalin krejtësisht nga qëllimi dhe kushtet e përcaktuara në aktet e mësipërme.

20. Në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, pakica ka çmuar se veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në funksion të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e të vetmes banesë që subjekti rezulton të ketë në pronësi të tij nga hetimi administrativ, nuk përbëjnë një aktivitet i cili duhet të konsiderohet se ka afektuar me paligjshmëri burimin e krijimit të pasurisë shtëpi banimi, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë.
21. Në vlerësimin tonë nuk qëndrojnë as konkluzionet e Komisionit dhe të shumicës së trupit gjykues të Kolegjit se subjekti ka kryer deklarime të pasakta në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011, për shkak të mosdeklarimit të shumës prej 4.900.000 lekë si pasuri likuiditet e tij për sa kohë që provohej se ajo shumë e disbursuar prej BKT-së, disponohej prej tij në fund të atij viti.
22. Së pari, në vlerësimin tonë subjekti e ka zbatuar detyrimin për deklaram të kësaj shume nëpërmjet deklaramit të saj si detyrim financiar ndaj BKT-së, në rubrikën e deklaramit të detyrimeve ndaj personave fizikë e juridikë, për pasojë kjo shumë nuk do të duhej të deklarohet edhe në rubrikën e ndryshimeve të pasurive, duke qenë se subjekti e kishte deklaruar marrëdhënien ligjore me të. Për më tepër, që në rubrikën e shtesave e ndryshimeve në formularët e deklarimeve periodike pasqyrohen pasuritë në pronësi e përdorim dhe jo ato që raportohen si detyrime ndaj të tretëve. Në çdo rast, subjekti ka deklaruar disbursimin e kësaj shume duke shlyer detyrimin ndaj organeve përkatëse në lidhje me këtë pasuri.
23. Të njëjtin qëndrim kundërshtues kemi mbajtur edhe për sa i përket konkluzionit të Komisionit dhe shumicës së trupit gjykues të Kolegjit se subjekti ka kryer pasaktësi në deklarimin periodik të vitit 2012, duke qenë se ai nuk ka deklaruar në deklaratën e pasurisë së këtij viti kontratën paraprake të sipërmarrjes, lidhur mes tij e shoqërisë “{***}” ShPK, në datën 23.04.2012. Në vlerësimin tonë, zbatimi i ligjit nr. 9049 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, përcakton detyrimin e subjekteve vetëdeklaruese të deklarojnë gjendjen e pasurive të tyre e të interesave privatë në datën 31 dhjetor të çdo viti përkatës dhe jo detyrimisht çdo ndryshim të këtyre të drejtave përgjatë vitit kalendarik. Në këtë kuptim, rezulton se subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2011, kontratën e sipërmarrjes së nënshkruar mes tij dhe shoqërisë “{***}” ShPK në datën 31.12.2012, e cila përmban të gjitha disponimet e palëve në lidhje me atë çka ata kanë dashur të kontraktojnë, dhe që ka përthithur edhe përmbajtjen e kontratës paraprake të datës 23.04.2012. Është pikërisht kjo kontratë ajo që ka përcaktuar të drejtat e detyrimet e palëve dhe të subjektit në raport me të drejtat e detyrimet e tij për vitin 2012.
24. Përveç sa më sipër, pakica vëren se këto pasaktësi të pranuar nga Komisioni dhe shumica e trupit gjykues në Kolegj u përkasin deklarimeve në deklaratat periodike të viteve 2011 e 2012, të cilat edhe sikur të qëndronin në drejtim të pasaktësive të konstatuara, përsëri nuk

mund të ngriheshin në nivelin e shkaqeve të shkarkimit, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

25. Konkluzioni i mësipërm është i vlefshëm për të argumentuar qëndrimin kundër vendimit të shumicës së trupit gjykues të Kolegjit, se subjekti ka kryer pasaktësi në deklarime në deklaratat periodike, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61 pika 3 e këtij ligji.
26. Në vlerësimin tonë, në konsekuencë edhe të qëndrimeve tashmë të konsoliduara, të mbajtura nga Kolegji⁸⁵, pasaktësitë në deklarime nuk mund të shërbejnë si shkelje të tilla të cilat të formojnë bazën e duhur ligjore për shkarkim. Ky qëndrim i mbështetur në parashikimin e nenit 33, pika 5 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, është analizuar i parë ngushtë me parashikimin në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, i cili kërkon si një parakusht për përgjegjësinë disiplinore për efekt të këtij procesi, përpjekjet e subjektit për defektimin e deklarimeve të tij në deklaratën *vetting*, parakusht që përjashton pasaktësitë në deklarime, si një premisë për shkarkim, përveç rastit kur ato janë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë apo deklarimin e pasaktë të të dhënave, përfshirë këtu edhe ato lidhur me burimet e krijimit të pasurisë, të cilat natyrshëm nuk mund të kualifikohen si pasaktësi, por si deklarime të rreme dhe fshehje e pasurisë. Referimi që bën neni 61, pika 3 te neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duhet interpretuar në harmoni me parashikimin kushtetues që u citua më lart.
27. Përpos të gjitha këtyre argumenteve, edhe sikur të konsideronim pasaktësitë në një kontekst të caktuar si shkelje që mund të prodhonin shkaqe për shkarkim, ato duhet të ishin konstatuar si të tilla në deklaratën *vetting* dhe jo në deklaratat periodike të pasurisë, të ishin të shumta e domethënëse, në kuptim dhe zbatim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.
28. Përfundimisht, në vlerësojmë se argumentet e Komisionit të mbështetura edhe nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, se veprimet juridike të kryera prej subjektit për kalimin e pronësisë mbi apartamentin në rrugën “{***}” në Tiranë dhe përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese nuk plotësojnë asnjë prej elementeve të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që të çojnë në aplikimin e masës së shkarkimit nga detyra.

II. Mbi pamundësinë e subjektit të rivlerësimit për të justifikuar të gjitha pasuritë e vëllait të tij, z. E. M., i konsideruar si person tjetër i lidhur i subjektit

29. Jemi dakorduar pjesërisht me qëndrimin e mbajtur nga shumica për sa i përket statusit si person tjetër i lidhur i vëllait të subjektit të rivlerësimit në raport me detyrimin e shpërpjesëtuar të këtij të fundit, për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tij sipas qëndrimit të mbajtur prej Komisionit. Për këtë arsye, pa dhënë argumente shtesë rreth këtij konkluzioni, i bashkohemi argumenteve të shumicës në këtë drejtim.
30. Kemi ndarë mendim të ndryshëm nga shumica, për sa i përket cilësimit të vëllait të subjektit të rivlerësimit si person tjetër i lidhur, në lidhje me shlyerjen e detyrimit prej tij të 1.000.000 lekëve ndaj subjektit të rivlerësimit dhe vendosjes në hipotekë të një shtëpie në pronësi të vëllait të subjektit, për garantimin e kredisë së marrë prej subjektit në Bankën Alpha. Në vlerësimin tonë, këto marrëdhënie të subjektit të rivlerësimit me vëllain e tij E. M. nuk e kualifikojnë vëllain e tij si person tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për pasurinë e të cilit subjekti ka detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit.

⁸⁵ *Vendimet e Kolegjit nr. 11/2018 (JR), datë 22.11.2018 dhe nr. 5/2019 (JR), datë 18.02.2019.*

31. Në referim edhe të qëndrimeve të mëparshme të mbajtura nga jurisprudenca e Kolegjit⁸⁶, persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, do të konsiderohen ata persona që kanë me subjektin një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të kësaj dispozite. Kolegji ka pranuar në trajtimet e mëparshme që i ka bërë këtij instituti, se jo çdo person i cili ka me subjektin një marrëdhënie interesi në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, do të jetë një person tjetër i lidhur sipas nenit 32, pika 4 e këtij ligji, por vetëm ata që gjenden me subjektin në marrëdhëniet e parashikuara nga kjo dispozitë ligjore. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji ka pranuar se pas konsiderimit si persona të tjerë të lidhur të kësaj kategorie, pra ata që gjenden në marrëdhënie huaje apo dhurimi me subjektin, vetëm për këto pasuri që përbëjnë objektin e kësaj marrëdhënieje, subjekti do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj.
32. Duke ndjekur këtë logjikë të elaboruar në mënyrë të posaçme në vendimet e mëparshme të Kolegjit, vërejmë se cilësimi i vëllait të subjektit si person tjetër i lidhur për dy shkaqet e pranuar nga shumica e trupit gjykues, nuk qëndron, duke qenë se në këndvështrimin tonë, ato rrethana nuk e bëjnë vëllain të konsiderohet si person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, pavarësisht marrëdhënies së krijuar mes tij e subjektit të rivlerësimit.
33. Rrethana e parë e cila është përdorur nga shumica e trupit gjykues për të bërë këtë cilësim, lidhet me deklarin e bërë prej vetë subjektit në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2011 e të shpjeguar më pas në përgjigjet e shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ se vëllai i tij i ka dhënë subjektit të rivlerësimit shumë prej 1.000.000 lekësh si shpërblim për cedimin e kredisë në vitin 2011, shumë e cila përfaqësonte pjesërisht vlerën e kredisë që subjekti kishte paguar deri në momentin e cedimit.
- Në analizë të kësaj rrethane, pakica çmon se shuma përbën një detyrim që vëllai i subjektit duhej të paguante ndaj subjektit për shkak të marrëdhënies në të cilën ata janë përfshirë për cedimin e kredisë dhe përfitimin e pronësisë mbi një apartament. Për shkak të kësaj marrëdhënieje, palëve iu kanë lindur të drejta e detyrime reciproke të cilat janë të titulluara t'i gëzojnë apo shlyejnë. Në këtë kuptim, kjo shumë nuk përbën dhe as përfaqëson një vlerë të shtuar të pasurisë së subjektit, por vetëm rikthim të një pasurie që ai e kishte nxjerrë më parë prej disponimit të tij për shkak të pagimit të detyrimeve kontraktuale me bankën. E trajtuar në këtë mënyrë, në vlerësimin tonë kjo shumë nuk përfaqëson as dhurim dhe as dhënie huaje drejt subjektit, por vetëm shlyerjen e një detyrimi. Për këtë arsye, ajo nuk mund të kualifikohet si një rrethanë që e bën vëllain person tjetër të lidhur në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe as të prodhojë për subjektin e rivlerësimit detyrimin për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj shume prej vëllait të tij.
34. Rrethana tjetër për të cilën është bërë ky cilësim nga shumica e trupit gjykues lidhet me vendosjen prej vëllait të subjektit në hipotekë të një apartamenti në pronësi të tij si kolateral për marrjen e kredisë nga BKT-ja, në vitin 2011, sipas kontratës së hipotekimit nr. {***} kol., datë 29.09.2011. Në vlerësimin tonë, ndryshe nga sa ka arsyetuar shumica, edhe kjo marrëdhënie nuk e vendos vëllain në statusin e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Vendosja e një pasurie si kolateral për të garantuar shlyerjen e një kredie, sigurisht që përfaqëson një marrëdhënie të rëndësishme besimi e një marrëdhënie të konsoliduar nga pikëpamja e lidhjeve të gjakut apo shoqërore kur ajo ndodh mes individëve që nuk kanë lidhje gjaku, por kjo marrëdhënie nuk passjell shtim të pasurisë në pronësi apo përdorim të subjektit të rivlerësimit, sipas pasojës që kanë dy institutet e parashikuara nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhurimi dhe huaja. Pavarësisht titullimit të kësaj kontrate si dorëzani, në përmbajtjen e saj konstatohet se vëllai i subjektit dhe bashkëshortja e tij kanë

⁸⁶ *Vendimet e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019 dhe nr. 20/2019 (JR), datë 31.07.2019.*

vënë në hipotekë pasurinë e tyre për të garantuar shlyerjen e kredisë prej subjektit të rivlerësimit dhe, në kuptim të dispozitave që rregullojnë këtë mjet për sigurimin e detyrimit, nenet 560 e vijues të Kodit Civil, ata përgjigjen potencialisht për garantimin e shlyerjes së detyrimit deri në vlerën e pasurisë së vënë në hipotekë dhe jo përtej saj, siç mund të kenë detyrimin të përgjigjen dorëzanësit e një detyrimi në kuptim të neneve 585 e vijues të Kodit Civil.

Në këto rrethana, kjo marrëdhënie nuk passjell për subjektin as të drejta pronësie dhe as përdorimi apo gëzimi të pasurisë së vënë në hipotekë, në mënyrë që ato të trajtoheshin në analogji me të drejtat e fituara nga kontrata e dhurimit apo e huas dhe të konsideroheshin si rrethana që i japin vëllait të subjektit cilësinë e personit tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

35. Të gjitha argumentet e renditura në këtë arsyetim sigurisht që nuk përjashtojnë të drejtën e organeve të rivlerësimit për të bërë çdo hetim e vlerësim të nevojshëm drejt situatave të konfliktit të interesit në këto raste apo për të bërë hetime rreth dyshimeve për fshehje të pasurive të subjekteve të rivlerësimit në emër të personave të tjerë të lidhur, të cilët mund të jenë ose jo familjarë të tyre. Përfundimisht, edhe në këtë drejtim, pakica ka vlerësuar se vëllai i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet me subjektin e rivlerësimit në marrëdhënie të tilla të parashikuara nga ligji për t'u cilësuar si një person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
36. Në vijim të këtij konkluzioni, pakica ka vlerësuar se edhe ky shkak i përdorur nga shumica e trupit gjykues të Kolegjit, si një shkak që cilëson subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sepse nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së vëllait të tij, të përbërë prej shumës 1000000 lekë dhe pasurisë apartament me sipërfaqe prej 55,8 m² dhe shtesës prej 10 m² të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, nuk qëndron.
37. Në këto kushte, pakica ka vlerësuar se nga vlerësimi dhe kontrolli i kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit nuk gjenden shkelje të tilla që ta kualifikojnë subjektin në njërin prej rasteve të shkarkimit nga detyra, të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 61 i ligjit nr. 84/2016.

III. Mbi cenimin e besimit të publikut

38. Jemi shprehur kundër qëndrimit të shumicës edhe për sa i përket cilësimit si shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të trajtimit të sjelljes së subjektit në kryerjen e veprimeve juridike për të fituar pronësinë mbi apartamentin e ndodhur në rrugën “{***}”, në Tiranë dhe financimin e kësaj pronësie me anë të një kredie me kushte lehtësuese, si një sjellje joetike që ka cenuar besimin e publikut të drejtësisë. Vota kundër në lidhje me këtë disponim të shumicës së trupit gjykues të Kolegjit lidhet me dy shkaqe, njëri i natyrës procedurale dhe tjetri i natyrës materiale, të cilat shtjellohen më poshtë.
39. *Së pari*, vlerësojmë se Kolegji nuk mund të shtojë shkaqe të reja shkarkimi për subjektin e rivlerësimit në një gjykim të tillë, i nisur dhe i vënë në lëvizje me ankimin e subjektit të rivlerësimit. Nga analiza e vendimit nr. 45, datë 23.07.2018, të Komisionit, konstatohet se subjekti është shkarkuar nga detyra në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pamjaftueshmëri të deklarimeve në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë. Subjekti nuk është njoftuar dhe as i është lënë mundësia të mbrohet në drejtim të shkeljes së parashikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 që ka shkaktuar cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë në atë nivel, saqë e bën të pamundur vazhdimin e ushtrimit të funksioneve

të tij. Ai as nuk ka parashtruar një mbrojtje në ankimin e tij në lidhje me këtë shkak, duke qenë se një shkak i tillë shkarkimi nuk ishte konstatuar nga organi që bën rivlerësimin e tij.

40. Në këtë kuptim, vlerësojmë se shumica e trupit gjykues të Kolegjit ka rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit në gjykim, në kundërshtim me parimin e *no reformatio in peius*, që garanton të drejtën e mbrojtjes së një subjekti në procesin e gjykimit në një shkallë më të lartë gjykimi. Përveçse një parim i njohur i së drejtës penale, ky parim është bërë gjithashtu pjesë e rregullave që normojnë edhe proceset administrative, në mënyrë të shprehur me hyrjen në fuqi të Kodit të Procedurave Administrative. Në nenin 137, paragrafi 5 i ligjit nr. 45/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, parashikohet se: *Nëse nuk është parashikuar shprehimisht ndryshe nga ligji, akti i organit epror mund të jetë vetëm në dobi të palës ankuese*. Në zbatim të këtij parimi dhe të parimeve procedurale të parashikuara në nenin 465, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit: *Në shqyrtimin e çështjes në apel mbahen parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë të parashikuara në këtë Kod, dhe nenit 28, sipas të cilit: Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrohen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm*, ne vlerësojmë se aplikimi i një shkak shkarkimi të ri, për të cilin Komisioni nuk është shprehur, në kundërshtim me parashikimet ligjore të cituara më lart, cenon të drejtën e subjektit për një proces të rregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.
41. *Së dyti*, kemi mbajtur qëndrimin kundër aplikimit të këtij shkak shkarkimi edhe për një arsye tjetër që lidhet me zbatimin e ligjit të posaçëm nr. 84/2016, i cili në vlerësimin tonë kushtëzon zbatimin e këtij rasti si shkak shkarkimi vetëm pasi janë vlerësuar të tria kriteret e procesit të rivlerësimit dhe nuk mund të jetë i aplikueshëm vetëm me kontrollin e verifikimin e vetëm një kriteri.
42. Në vijim të këtij arsyetimi, konsiderojmë të rëndësishme të ndalemi fillimisht në faktin se edhe Komisioni, edhe shumica e trupit gjykues në Kolegj ka analizuar sjelljen e subjektit të rivlerësimit në drejtim të shkeljes së etikës, duke u bazuar vetëm në rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë. Në zbatim të nenit 40 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *Objekti i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit në përputhje me këtë ligj dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve*, etika është një nga komponentët që vlerësohet gjatë kontrollit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit dhe, si e tillë, ajo duhet trajtuar dhe analizuar në këndvështrim të këtij kriteri të procesit. Elementet e etikës gjyqësore, sipas parashikimeve të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që të referon te parashikimi i nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, por edhe të etikës jashtëgjyqësore, vlerësojmë se duhet të analizohen në raport me elementet e tjera të këtij kriteri, për t’u dhënë atyre peshën e duhur dhe për të vlerësuar në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, efektin që ato do kenë në konsiderimin e shkeljeve të kësaj natyre, kur ato ekzistojnë. Trajtimi i tyre më vete dhe si element përbërës i kriterit të kontrollit të pasurisë, nuk gjen mbështetje në parashikimet ligjore të cituara më lart dhe, për pasojë, nuk lejon një vlerësim objektiv të vetë rrethanave konkrete të pretenduara se përbëjnë shkeljen e etikës.
43. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk i është nënshtruar vlerësimit në drejtim të kontrollit të kriterit të aftësive profesionale për të trajtuar e analizuar shkeljen e pretenduar prej Komisionit dhe shumicës së trupit gjykues në Kolegj, në raport edhe me vetë kriterin e kontrollit të aftësive profesionale, analiza e këtyre rrethanave në këndvështrim të zbatimit të

nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, bëhet e pamundur sipas vlerësimit tonë, për sa kohë që organet e rivlerësimit nuk kanë kryer një vlerësim tërësor të tri kriterëve të rivlerësimit.

Neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon si shkak shkarkimi të subjekteve të rivlerësimit rastin kur: [...] nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, që sipas vlerësimit tonë do të thotë se kërkon vlerësimin e të tria kriterëve të rivlerësimit, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Ky parashikim kërkon në vlerësimin e pakicës që cenimi i besimit të publikut të ketë ndodhur, të jetë i arsyeshëm e i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, edhe për shkaqe e shkelje që në vetvete nuk përbëjnë shkaqe për aplikimin e rasteve të tjera të shkarkimit të parashikuara prej nenit 61, pikat 1, 2, 3 e 4 të ligjit nr. 84/2016. Për shkak të këtij këndvështrimi, vlerësojmë se cenimi i besimit të publikut të drejtësia, në kuptim të kësaj dispozite, duhet të arsyetohet e mbështetet në vlerësimin tërësor të tri kriterëve të rivlerësimit apo në vlerësimin e përgjithshëm të procedurave të rivlerësimit në raport me sjelljen e subjektit gjatë këtij procesi, por nuk vjen në frymën e ligjit vlerësimi i cenimit të besimit të publikut të drejtësia, duke analizuar në mënyrë të veçantë vetëm njërin prej kriterëve të rivlerësimit.

Për sa më sipër, pakica ka votuar kundër disponimit të trupit gjykues për përcaktimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si një shkak shkarkimi për subjektin e rivlerësimit Ervin Metalla.

IV. Mbi zgjidhjen e çështjes

44. Në kushtet e arsyetimit të mësipërm, pakica e trupit gjykues të Kolegjit ka vlerësuar se, duke qenë se shkaqet për të cilat është vendosur shkarkimi i subjektit nuk qëndrojnë në lidhje me kriterin e pasurisë dhe se është e pamundur të vlerësohet zbatimit i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 në kushtet e përshkruara më lart, vendimi i Komisionit objekt gjykimi, i cili ka vendosur shkarkimin e subjektit, nuk mund të qëndrojë në fuqi.
45. Në kushtet e pamundësisë për t'u shprehur me një vendim që zgjidh çështjen përfundimisht për shkak të mungesës së hetimit e vlerësimit të kriterëve të tjera të rivlerësimit nga Komisioni, i cili kryen procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit, pakica çmon se gjen vend aplikimi i nenit 66, pika 1, germa "c" e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit vendimi nr. 45, datë 23.07.2018, duhet të priset dhe çështja t'i dërgohet për të vazhduar procesin e rivlerësimit Komisionit për dy kriteret e tjera.
Në zbatim të përcaktimit kushtetues të parashikuar nga neni F, paragrafi 3 i Aneksit të Kushtetutës së Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund ta kthejë atë për rishqyrtim, vlerësojmë se ai nuk është një përcaktim ndalues në këtë rast, duke qenë se ekziston ndryshimi thelbësor që lidhet me faktin se Komisioni nuk ka kryer një hetim apo vlerësim për kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, atë të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale, situatë që nuk vendos dërgimin e çështjes në Komision në të njëjtën pozitë procedurale me rishqyrtimin për të cilin shprehet me ndalim neni F i Aneksit të Kushtetutës.
46. Në këto rrethana, gjykojmë se Kolegji si një gjykatë e shkallës së dytë, që ka në juridiksionin e saj shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Komisionit, nuk mundet të bëjë një vlerësim parësor të procesit të rivlerësimit për kriteret për të cilat Komisioni nuk ka ushtruar kompetencat e tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, edhe për shkak se në këtë mënyrë do të bënte të pazbatueshme të drejtën e subjektit për të ushtruar ankim ndaj këtij vendimi në versionin që do të kishte një konkluzion negativ për kriteret e pashqyrtuara më parë, duke cenuar të drejtën për një ankim efektiv, të parashikuar nga neni 43 i Kushtetutës së

Republikës së Shqipërisë dhe neni 13 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Liritë Themelore të Njeriut.

47. Në këto kushte, gjykojmë se vendimi objekt shqyrtimi duhet të priset e çështja t'i dërgohet Komisionit për të vazhduar më tej me procedurën e rivlerësimit për kriteret e mbetura pa u vlerësuar, deri në arritjen e një konkluzioni përfundimtar për subjektin e rivlerësimit, në varësi të rezultateve të hetimit e konkluzioneve të nxjerra prej tyre.

Gjyqtare

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

Gjyqtare

Ina RAMA

nënshkrimi